

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5826  
E shtunë, 13 korrik 2019  
çmimi 0.40 €

## UNDP-ja ia dhuron Policisë së Kosovës 36 kompjuterë



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", BEHXHET SHALA | FAQE 4-5



# Opozita problemin më të madh e ka se kush do të bëhet kryeministër

Analisti politik Behxhet Shala e sheh shumë të vështirë një bashkëpunim apo koalicion në mes të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-së) dhe Lëvizjes Vetëvendosje (LV-së). Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e

re" ai ka thënë se këto dy parti nuk kanë asnjë pikë të përbashkët. Sipas Shalës, problemi kryesor ndërmjet këtyre dy partive do të jetë posti i kryeministrit. Ai ka bërë me dije se partitë politike në vend tani janë në pat pozicion. Shala ka

vlerësuar se as zgjedhjet e parakohshme nuk do të sillnin diçka të re. Sipas tij, e keqja e Kosovës është se në horizontin politik nuk ka ndonjë forcë politike e cila do t'i siguronte qytetarët se do të bënte reforma të thella

## KDI-ja: Kuvendi nuk ka arritur ta mbikëqyrë zbatimin e asnjë ligji gjatë këtij viti

Kuvendi i Kosovës ka treguar zero performancë në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve gjatë periudhës janar-korrik të këtij viti. Këto janë të dhënat e analizës së publikuar të premtën nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Përfaqësuesit e KDI-së, Artan Murati dhe Blerta Aliu, kanë thënë se shkaktarët kryesorë që po ndikojnë në

mbikëqyrje të ulët të zbatimit të ligjeve janë zbrazëtitat ligjore në Rregulloren e Punës së Kuvendit, mungesa e metodologjisë së mbikëqyrjes së punës së komisioneve si dhe mosmiratimi i raporteve të komisioneve për mbikëqyrje të zbatimit të ligjit në seanca plenare si pasojë e mungesës së kuorumit | FAQE 7



**Ish-ministri Bajram Hasani aderon në AAK** | FAQE 2

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curez-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

044/256-051  
044/367-061  
**STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË**

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

### AKTUALE

**ARTAN NIMANI ZGJEDHET REKTOR I UNIVERSITETIT 'FEHMI AGANI' NË GJAKOVË** F. 3

**PROCEOHEP PËR KUVEND INICIATIVA PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT HETIMOR PËR VETERANËT E UÇK-së** F. 6

**QEVERIA DO TA RREGULLOJË STATUSIN E TË PLAGOSURVE DHE INVALIDËVE NË PROTESTAT PARA '98-S** F. 5

### EKONOMI



**KRYEMINISTRI NIS SEZONIN E KORRJE-SHIRJEVE** F. 9

**TRUSTI: MBI 100 MILIONË EURO RRRITJE NGA INVESTIMET PËR GJASHTËMUJORIN E PARË** F. 8

### KULTURË

**MKRS-ja PASURON FONDIN E BIBLIOTEKAVE PUBLIKE** F. 13

**POEZIA E RISEMANTIZIMIT TË KODIT EROTIK TË LULZIM TAFËS**



F. 12

Shkruan: Sali BASHOTA

### SPORT

**DY MEDALJE DHE NJË DËSHTIM NË HUNGARI** F. 16



## Policia e Shqipërisë arreston luftëtarin rus të Shtetit Islamik

TIRANË, 12 KORRIK - Një shtetas rus, i akuzuar se ka luftuar për grupin militant Shteti Islamik, është arrestuar nga Policia e Shqipërisë. I arrestuari do të ekstradohet në Rusi. Policia në Shqipëri ka njoftuar se 34-vjeçari, i identifikuar si R. M., i cili është lindur në qytetin Norilsk të Rusisë, ka hyrë ilegalisht në Shqipëri, pasi një gjykatë

në Republikën ruse të Çeçenisë vendosi për arrestimin e tij për shkak të pjesëmarrjes në grupin terrorist. "Në qershor të 2013-s, ky qytetar, nga Rusia ka shkuar në Siri, duke iu bashkuar grupit të armatosur i quajtur 'Shteti Islamik' dhe ka qenë pjesëmarrës aktiv në luftime kundër forcave qeveritare të Sirisë", thuhet në

njoftimin e policisë.

Aty thuhet se Njësia Antiterror e Shqipërisë ka shpenzuar muaj të tërë për ta gjetur lokacionin dhe identifikuar shtetasin rus, që kërkohet nga Interpoli i Moskës. Gjatë muajve të verës në Shqipëri ka rritje të fluksit të qytetarëve rusë dhe ukrainas, që shkojnë si turistë.



## DASH-i: Korrupsioni po e sfidon zhvillimin ekonomik të Kosovës

PRISHTINË, 12 KORRIK - Departamenti Amerikan i Shtetit ka publikuar raportin mbi klimën e biznesit në botë. Në pjesën për Kosovën theksohet se bizneset vendore dhe ndërkombëtare e citojnë rregullisht korrupsionin si një nga pengesat më të mëdha të Kosovës për tërheqjen e investimeve. "Kosova ka miratuar ligje të ashpra për ta luftuar korrupsionin, por qeveria deri më tani ka qenë e pasuksesshme në përpjekjet për të hetuar, ndjekur penalisht, burgosur

dhe konfiskuar asetet e individëve të korrumpuar", thuhet në raportin e DASH-it. Megjithatë, raporti thekson se përkundër faktit se Kosova është një nga vendet më të reja dhe më të varfra në Evropë, ka shënuar ritme pozitive të rritjes ekonomike, mesatarisht pothuajse katër për qind gjatë dekadës së fundit. "Përderisa zbatimi i ligjit mbetet i dobët, ligjet dhe rregulloret janë në përputhje me përkrahjen dhe mbrojtjen e investimeve", theksohet në raport.

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit përmend një varg arsyesh që e sfidojnë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës, si integrimi ekonomik i kufizuar rajonal dhe global, furnizimi jo i sigurt me energji elektrike, sundimi i dobët i ligjit si dhe korrupsioni.

DASH-i thotë se Kosova vazhdon të mbështetet në përkrahjen e konsiderueshme financiare ndërkombëtare dhe remitanat (dërgesat e qytetarëve që jetojnë jashtë vendit).



## Meta nuk e dekreton Skënder Gjinushin kryetar të Akademisë së Shkencave



TIRANË, 12 KORRIK (ER) - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka refuzuar dekretimin e Skënder Gjinushit kryetar i ri i Akademisë së Shkencave. Dorëheqja nga funksioni i kryetarit të Partisë Socialdemokrate, e paraqitur nga Skënder Gjinushi më 15. 05. 2019, nuk është formalizuar me një vendimmarrje ligjore përpara kohës së zhvillimit të zgjedhjeve për kryetar të Akademisë së Shkencave në datën 24. 05. 2019. Sipas presidentit Meta, ky është shkak i mosdekretimit të Gjinushit në krye të Akademisë së Shkencave.

Në arsyet e mosdekretimit nga ana e presidentit thuhet: "Me

qëllim të zhvillimit të një procesi me transparencë të plotë, të drejtë, objektiv dhe të paanshëm, presidenti i Republikës realizoi një takim me z. Skënder Gjinushi, në cilësinë e kryetarit të zgjedhur të Akademisë së Shkencave, me të cilin ka bashkëbiseduar për të gjitha çështjet që lidhen me zgjedhjen e tij në këtë pozicion, si dhe me shqetësimet e debatit publik që ka përshirë opinionin për shkak të zhvillimit të zgjedhjeve për organet drejtuese të Akademisë së Shkencave. Presidenti Ilir Meta ka mbërritur në përfundimin se 'procesi zgjedhor i zhvilluar më datën 24. 05. 2019 në Akademinë e Shkencave, për

zgjedhjen e kryetarit të Akademisë së Shkencave, paraqet problematikë të theksuar ligjore".

Kjo gjendje paligjshmërie, thotë presidenti Meta, e bën të pamundur për ta emëruar kryetarin e Akademisë së Shkencave.

Presidenti Meta ka theksuar se procesi i kandidimit dhe ai zgjedhor i zhvilluar dhe i përfunduar më datën 24. 05. 2019 për zgjedhjen e kryetarit të Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë paraqet shkelje të parashikimeve të Ligjit nr. 9655, datë 11. 12. 2006 për "Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë".

## Ish-ministri Bajram Hasani aderon në AAK

PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Ish-ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, që ishte pjesë e Nismës Socialdemokrate, i është bashkuar të premten Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Lajmi është bërë me dije nga lideri i AAK-së,

Ramush Haradinaj. "Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës iu bashkuan sot ish-ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, asamblistja e Kuvendit Komunal e Gjilanit, profesoresha Anila Tusha-Kastrati, Abdyl Brestovci, ekonomist i shquar dhe

Burhan Arifi, stomatolog i njohur. Interesimi për t'iu bashkuar vizionit të AAK-së për shtetin e fortë është i jashtëzakonshëm dhe kjo na inkurajon të punojmë pandalshëm në shërbim të vendit", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".





Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar analizën lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve nga Kuvendi

## KDI-ja: Kuvendi nuk ka arritur ta mbikëqyrë zbatimin e asnjë ligji gjatë këtij viti

Kuvendi i Kosovës ka treguar zero performancë në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve gjatë periudhës janar-korrik të këtij viti. Këto janë të dhënat e analizës së publikuar të premten nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Përfaqësuesit e KDI-së, Artan Murati dhe Blerta Aliu, kanë thënë se shkaktarët kryesorë që po ndikojnë në mbikëqyrje të ulët të zbatimit të ligjeve janë zbrazëtitrat ligjore në Rregulloren e Punës së Kuvendit, mungesa e metodologjisë së mbikëqyrjes së punës së komisioneve si dhe mosmiratimi i raporteve të komisioneve për mbikëqyrje të zbatimit të ligjit në seanca plenare si pasojë e mungesës së kuorumit

metodologjisë së mbikëqyrjes së punës së komisioneve, mungesa e kapaciteteve dhe mosshfrytëzimi i resurseve financiare të komisioneve, mosmiratimi i raporteve të komisioneve për mbikëqyrje të zbatimit të ligjit në seanca plenare si pasojë e mungesës së kuorumit janë shkaktarët kryesorë që po ndikojnë në mbikëqyrje të ulët të zbatimit të ligjeve", ka deklaruar Aliu, duke shtuar se injorimi i të gjeturave të komisionit nga ana e ekzekutivit, neglizhenca e deputetëve si dhe volumi i punës në komisione janë shkaktarët kryesorë që po ndikojnë në numrin e ulët të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve nga ana e komisioneve parlamentare.

Ajo ka theksuar se komisionet parlamentare në planet e tyre të punës vazhdojnë të reflektojnë joproporcionalisht rolet dhe përgjegjësitë që kanë. "Shqyrtimi i projektligjeve është aktiviteti kryesor, ndërsa mbikëqyrja është aktiviteti më marginal. Për ilustrim, planet e punës së 14 komisioneve parlamentare për 2019-n përfshijnë shqyrtimin e 116 projektligjeve, ndërsa monitorimin e vetëm 23 prej tyre", ka thënë Aliu. Sipas saj, në vitin 2019 shtatë nga

katërmbëdhjetë komisionet e Kuvendit nuk kanë diskutuar asnjëherë për çështjen e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve. Për më tepër, dy raporte të monitoruara gjatë 2018-s nuk kanë arritur të miratohen në seancën plenare për shkak të mungesës së kuorumit.

Gjithashtu, Aliu ka treguar se komisionet parlamentare nuk kanë konsistencë në kërkim të llogarisë nga dikasteret qeveritare lidhur me zbatimin e rekomandimeve që dalin nga raportet për mbikëqyrjen e ligjeve të caktuara.

Kurse deputetët e mandatuar në grupe punuese për mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve kanë thënë se e shohin si "joaktiv" dhe pa përfitim angazhimin e tyre për mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve pasi, sipas tyre, ky aktivitet nuk u siguron vizibilitet në publik. "Komisionet parlamentare, edhe në rast kur realizojnë mbikëqyrje, atë e bëjnë pa një udhëzues apo metodologji të qartë. Në rastet kur kanë nevojë për ekspertizë të jashtme, atë e shfrytëzojnë përmes asistencës së shoqërisë civile", ka theksuar ajo.

Për t'u evituar këto probleme KDI-ja ka rekomanduar që

komisionet parlamentare në planet e tyre të punës t'i shpërndajnë në mënyrë proporcionale funksionet dhe përgjegjësitë që lidhen me bërjen e ligjeve, mbikëqyrjen si dhe t'i rishikojnë praktikën e përcaktimit dhe përzgjedhjes së ligjeve për mbikëqyrje. Ky institut ka rekomanduar që Kuvendi i Kosovës të adoptojë një metodologji të qëndrueshme dhe praktike me të cilën do të shërbeheshin komisionet parlamentare gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve. Sipas KDI-së, Kuvendi në mënyrë të vazhdueshme duhet të kërkojë llogari dhe informata nga qeveria lidhur me përmbushjen e rekomandimeve të dala nga raportet e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve.

KDI-ja rekomandon që Kuvendi ta marrë në konsideratë edhe sigurimin e ekspertizës së nevojshme që të realizohet mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve në formë adekuate. Po sipas KDI-së, deputetët e Kuvendit të Kosovës duhet t'i përmbushin obligimet dhe të kontribuojnë në mënyrë kualitative në grupet punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit duke mos e neglizhuar dhe zvarritur procesin.

**EPOKA  
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 12 KORRIK - Edhe pse Kuvendi i Kosovës dhe trupat e tij e kanë përgjegjësi kryesore mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, këtë funksion e përmbushin në shkallë të vogël dhe pa një metodologji efikase. Kështu kanë deklaruar të premten përfaqësuesit e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) në një konferencë për medie, në të cilën kanë publikuar analizën lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve nga Kuvendi. Ata kanë bërë me dije se nga janari deri në korrik të këtij viti Kuvendi nuk ka arritur ta mbikëqyrë zbatimin e asnjë ligji, kurse gjatë vitit të kaluar, sipas tyre, komisionet parlamentare kanë realizuar një mbikëqyrje duke përmbushur vetëm 4 për qind të planifikimeve vjetore.

Artan Murati nga KDI-ja ka thënë se, krahas raporteve ndërkombëtare, KDI-ja në raportet e saj periodike për punën e Kuvendit e ka cilësuar mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve si pikën më të dobët të Kuvendit, duke vlerësuar se deputetët në vazhdimësi nuk e kanë trajtuar me seriozitet këtë çështje. "Kuvendi ka dështuar për përmbushjen e objektivave të veta minimale lidhur me monitorimin e zbatimit të ligjeve si në planifikimin, po ashtu edhe në realizimin e planeve të punës së komisioneve", ka thënë ai.

Lidhur me këtë performancë të ulët Murati ka rikujtuar se

Kuvendi i Kosovës është kritikuar në çdo raport të Komisionit Evropian tash e 10 vjet. Ndërsa Blerta Aliu nga KDI-ja ka listuar shkaktarët që ky institut ka identifikuar lidhur me numrin e ulët të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve. Ajo ka thënë se performanca e ulët e Kuvendit në këtë pikë është kryesisht rezultat i disa faktorëve të brendshëm të këtij institucioni. "Zbrazëtitrat ligjore në Rregulloren e Punës së Kuvendit, mungesa e



## Artan Nimani zgjedhet rektor i Universitetit "Fehmi Agani" në Gjakovë



**GJAKOVË, 12 KORRIK (ER)** - Profesor Artan Nimani është zgjedhur të premten rektor i Universitetit "Fehmi Agani" në Gjakovë. Nimani është zgjedhur në këtë pozitë nga Këshilli Drejtues i

këtij universiteti, i përbërë nga shtatë anëtarë: Mazllom Kumnova, Ismet Bardhoshi dhe Adrian Kryeziu, të cilët janë të emëruar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë

(MASHT) si dhe të emëruarit nga universiteti: Besim Muhadri, Lulëzim Zeneli, Kushtrim Grezda dhe Labinot Berisha. Në garë për këtë pozitë kanë qenë Artan Nimani, Kamber Kamberi

dhe Sidorela Doli. Mandati i rektorit të Universitetit "Fehmi Agani" në Gjakovë është katër-vjeçar. Deri më tani rektor i këtij universiteti ka qenë Shaban Buza.



Flet për "Epokën e re", Behxhet Shala

# Opozita problemin më të madh e ka

Analisti politik Behxhet Shala e sheh shumë të vështirë një bashkëpunim apo koalicion në mes të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-së) dhe Lëvizjes Vetëvendosje (LV-së). Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ai ka thënë se këto dy parti nuk kanë asnjë pikë të përbashkët. Sipas Shalës, problemi kryesor ndërmjet këtyre dy partive do të jetë posti i kryeministrit. Ai ka bërë me dije se partitë politike në vend tani janë në pat pozicion. Shala ka vlerësuar se as zgjedhjet e parakohshme nuk do të sillnin diçka të re. Sipas tij, e keqja e Kosovës është se në horizontin politik nuk ka ndonjë forcë politike e cila do t'i sigurote qytetarët se do të bënte reforma të thella

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 12 KORRIK -

**"Epoka e re":** Z. Shala, opozita çdo ditë po paralajmëron se shumë shpejt do ta rrëzojë qeverinë, ndërsa pozita po e quan joserioze iniciativën e subjekteve opozitare për ta rrëzuar qeverinë me anë të mocionit të mosbesimit?

**Shala:** Opozita e ka ndërmend ta shpenzojë tërë mandatin duke e kërcënuar qeverinë me mocion, ndërsa deri më tani nuk ia ka arritur. Opozita shpesh po deklarohet se i ka votat e nevojshme. Madje deputeti Ilir Deda deklaroi se kanë pasur mundësi ta rrëzojnë qeverinë në muajin qershor. Ma merr mendja se nuk e kanë rrëzuar muajin e kaluar për ta prishur pushimin. Opozita vazhdimisht po deklarohet se është afër që t'i sigurojë votat e nevojshme për rrëzimin e qeverisë. Mendoj se të dyja palët janë joserioze në këtë aspekt. Në Kosovë të jesh joserioz është gjendje normale. Në anën tjetër, pozita po thotë se kurdo që opozita t'i bëjë 61 vota le ta rrëzojë qeverinë. Ajo e di se opozita nuk i ka votat.

**"Epoka e re":** Kjo opozitë, a mund ta rrezojë qeverinë?

**Shala:** Në këtë drejtim Lisa Serbe është bërë si mollë sherri, gjoja se me këtë subjekt politik nuk do të rrëzohet qeveria. Jemi në një gjendje që opozita nuk është e koordinuar si duhet dhe, po ashtu, duket se në mesin e opozitës nuk ka gatishmëri për ta rrëzuar pozitën. E kemi parë

se kur Shpend Ahmeti takohet me Ramush Haradinajn shkrihet. Dhe ka raporte aq të mira sa nuk besoj se ka dëshirë apo guxim ta prishë atë harmoni me Haradinajn dhe ta përkrahë mocionin për rrëzimin e qeverisë. Tani për tani jemi në pozicionin pat. Opozita nuk ka mundësi t'i bëjë votat e nevojshme për ta rrëzuar qeverinë, ndërsa pozita po frikësohet pak, por jo aq shumë sa të trembet se mund të rrëzohet nga kjo opozitë, sepse e di që opozita nuk i ka votat e nevojshme.

**"Epoka e re":** Deri kur mendoni se do të mund të vazhdojë ky pat pozicion?

**Shala:** Pat pozicioni do të vazhdojë derisa nuk mbledhin mend pozita dhe opozita. Opozita duhet ta ndaj mendjen nëse vërtet do ta rrëzojë qeverinë. Partitë opozitare duhet ta kenë një takim, ku liderët e tyre e marrin një vendim për rrëzimin e qeverisë. Deri më tani nuk kemi parë kesi gatishmëri, sepse opozita problemin më të madh e ka se kush do të bëhet kryeministër në të ardhmen. A do të jetë kryeministër Albin Kurti apo a do të jetë president Isa Mustafa. Ndërsa PSD-ja nuk besoj se ka shumë dëshirë që Albin Kurti të bëhet kryeministër, sepse nuk do të ndihej rehat. Po ashtu, edhe disa subjekte të koalicionit qeverisës nuk janë të interesuar ta rrëzojnë këtë qeveri. Nisma dhe AKR-ja postet që kanë në këtë qeveri në të ardhmen vetëm mund t'i ëndërrojnë. Pra, nuk heqin dorë aq lehtë nga pushteti sepse u ka sjellë shumë privilegje.

**"Epoka e re":** Lideri i LDK-së ka paralajmëruar mundësinë e një bashkëpunimi me Lëvizjen Vetëvendosje në mënyrë që qeveria e ardhshme të mund të formohet nga opozita e tanishme. Sa besoni se është i mundshëm ky bashkëpunim?

**Shala:** Nëse e marrim profilin politik të Lëvizjes Vetëvendosje dhe atë të LDK-së, dhe nëse marrim të kaluarën e afërt dhe të largët të këtyre dy subjekteve politike, atëherë do të bindeni se ky është koalicioni më i panatyrshëm. Pothuajse këto dy parti politike nuk e kanë asnjë pikë të përbashkët, as në aspektin politik, as në atë kombëtar e as në aspektin strategjik. Këto subjekte politike i lidhë vetëm interesi për ta rrëzuar këtë qeveri dhe shpresa për ta marrë pushtetin në të ardhmen. Kështu që, nuk besoj se mund të funksionojë ky koalicion edhe nëse shkohet në zgjedhje. Mendoj se posti i kryeministrit do të jetë problem për një bashkëpunim të mundshëm të këtyre dy subjekteve politike, po ashtu edhe posti i ministrit të Drejtësisë dhe atij të Punëve të Brendshme. Mendoj se Lëvizja Vetëvendosje do ta aspirojë postin e kryeministrit, sepse ky ka qenë synimi i Albin Kurtit. Lëvizja Vetëvendosje, për ta dëshmuar përpjekjen se do ta luftojë korrupsionin apo krimin e organizuar, domosdoshmërisht do të kërkojë ta ketë Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë. Po flas hipotetiki, nëse i merr këto dy ministri, atëherë duhet t'i bjerë fort edhe LDK-së, edhe një pjese të LV-së që nuk është



shumë e pastër. Natyrisht se vështirë do të mund ta lejonte këtë LDK-ja. Në këtë mënyrë, përveç luftës për pushtet, këto dy parti nuk kanë asnjë pikë tjetër të përbashkët. Nëse Lëvizja Vetëvendosje hyn në një koalicion me LDK-në, këta janë në një farë ndërvarësie mes vete dhe nuk do të mund të bëjnë ndonjë veprim pa u konsultuar njëra me tjetrën. Nuk besoj se do të lejojnë të vijnë në një gjendje që ta godasin njëra-tjetrën. Prandaj, është bukur

problem të besohet se mund të arrihet një koalicion i tillë dhe të funksionojë. Kosova ka nevojë të lirohet nga dukuritë negative si korrupsioni, krimi i organizuar dhe nepotizmi.

**"Epoka e re":** Në bazë të këtyre rrethanave, kur mund të shkojë vendi në zgjedhje të reja?

**Shala:** Në një shkrim për gazetën tuaj para disa muajve pata paralajmëruar se në fund të vjeshtës mund të ketë zgjedhje. Ende besoj se mund të ketë

## Qeveria do ta rregullojë statusin e të plagosurve dhe invalidëve në protestat para '98-s

PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të premtën në takim anëtarët e Komisionit për të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Kosovës, me të cilët ka biseduar për statusin e të plagosurve dhe invalidëve në protesta gjatë lëvizjes së rezis-

tencës së para luftës së vitit 1998. Me këtë rast, ai ka premtuar se qeveria dhe Kuvendi do të jenë të përkushtuar për rregullimin e statusit të kësaj kategorie të shoqërisë. "Pata një takim me deputetët, anëtarë të Komisionit për të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Kosovës, me të cilët diskutuam

për statusin e të plagosurve dhe invalidëve në protesta gjatë lëvizjes së rezistencës së para luftës së vitit 1998. Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi do të jenë të përkushtuar për rregullimin e statusit të kësaj kategorie të shoqërisë sonë", ka thënë Haradinaj pas takimit.





# se kush do të bëhet kryeministër



zgjedhje në këtë kohë. Natyrisht se pozitës nuk i takon të pranojë se do të ketë zgjedhje këtë vit, sepse pozita nuk është aq e sigurt se nëse shkohet në zgjedhje do të mund ta ruante pozicionin që ka.

**"Epoka e re":** A do të ishin zgjedhjet e reja zgjidhje?

**Shala:** Fatkeqësisht, nuk kemi ndonjë zgjidhje e cila ofron përmirësim të situatës në mënyrë të shpejtë. Ta zëmë se në pushtet do të vijë LDK-ja në

koalicion me LV-në dhe me ndonjë subjekt tjetër politik, prapë nuk do të jemi në gjendje t'i lëvizim gjërat në ndonjë shpejtësi të dëshiruar. Është problem, për të mos thënë e pamundur, që në Kosovë të ketë ndryshime të mëdha, të cilat do t'i dëshironin qytetarët e vendit. Nuk mund të bëhen ndryshime me njerëz që janë në pushtet që 20 vjet. Këtu e kam fjalën për LDK-në. Po i shihni se çka po ndodh në këto kuvende zgjedhore të LDK-së. Pothuajse aty

nuk ka asnjë forcë të re, aty janë ata njerëz me ambicie shumë karrieriste dhe janë shndërruar në despotë të vërtetë brenda kësaj partie. Këta nuk janë njerëzit që i sjellin ndryshime vendit. Pastaj Isa Mustafa nuk e ka autoritetin që ka pasur më herët dhe po shihet se i ka dalë situata nga duart. Pothuajse në çdo kuvend të LDK-së kemi përplasje apo hedhje të karrigeve, që më herët nuk ka ndodhur, përjashtoj atë kuvendin e famshëm kur u nda LDK-ja. Në

këtë proces po tregohet se LDK-ja nuk është e gatshme t'u japë hapësirë forcave të reja politike të cilat e duan një reformë. Një LDK e tillë është e pamundur të bëjë ndryshime. Pra, LDK-ja e sotme nuk është partia e cila merr vendime të rëndësishme për shtetin. Kjo pjesa më e vjetër e LDK-së është një partive akomoduese e cila e ka një retorikë të fortë, por ku vjen puna për të marrë vendime, nuk është në gjendje të marrë ndonjë vendim. As Lëvizja Vetëvendosje

nuk e ka më atë prestigjin që ka pasur më herët pas ndarjes. Mos të flas për partitë në pushtet të cilat nuk bëjnë ndonjë dallim. Pra, e keqja e Kosovës është se në horizontin politik nuk ka ndonjë forcë politike e cila siguron se do të ketë reforma në të mirë të qytetarëve apo t'i shtyjë proceset përpara. Në të gjitha partitë politike, përveç AAK-së, ka tendenca të përçarjes dhe një luftë për pushtet brenda partisë. Në këtë mënyrë nuk mund të ecet përpara.

## Ministri Tahiri falënderon UNDP-në për mbështetjen e dhënë në sektorin e drejtësisë

PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka pritur të premtën në takim njoftues përfaqësuesen e përhershme të UNDP-së në Kosovë, Maria Suokko, të cilën e ka uruar për pozitën e re dhe e ka njoftuar për zhvillimet dhe rezultatet në fushën e sundimit

të ligjit. Ministri Tahiri e ka falënderuar UNDP-në për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme në sektorin e drejtësisë, veçanërisht në fushën kundërkorrupsionit ku, si rezultat i bashkëpunimit të ndërsjellë, janë arritur rezultate në

fushën e legjislacionit dhe politikave. Tahiri ka shprehur përkushtimin për forcimin e bashkëpunimit me UNDP-në në proceset aktuale si dhe projektet në të ardhmen që do të dalin nga rishikimi funksional i sektorit të sundimit të ligjit.

Ndërsa Suokko ka përgëzuar ministrin Tahiri për rezultatet e arritura në sektorin e drejtësisë si dhe ka shprehur gatishmërinë për të ofruar mbështetje për zbatimin e legjislacionit dhe forcimin e kapaciteteve.





# Shoqata e Invalidëve të Luftës, e pakënaqur me udhëzimin administrativ për lehtësimet doganore e tatimore për invalidët e luftës

**EPOKA ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 12 KORRIK - Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së përmes komunikate për media ka reaguar në lidhje me ndryshimet e bëra në Udhëzimin Administrativ MF-NR.03/2019 për procedurat e realizimit të të drejtave në lehtësimet doganore dhe tatimore për invalidët e luftës.

Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së, e cila drejtohet nga kryetari Fadil Shurdhaj, ka theksuar se është e pakënaqur me ndryshimet e bëra në këtë udhëzim administrativ. "Udhëzimi Administrativ i hartuar nga Ministria e Financave nuk ka bërë asnjë lehtësim për invalidët e luftës së UÇK-së dhe kjo dëshmohet me nenin 7, ku parashihet dëshmimi i statusit të invalidit të luftës në paragrafin 1, nënparagrafët 1.3 dhe 1.4, në të cilët kërkohet që invalidi i luftës ta ketë patentën e shoferit për t'i përfutur lehtësimet doganore dhe tatimore për automjete. Kjo dispozitë ligjore e nenit 7 është diskriminuese dhe shkel vazhdimisht rëndë të drejtat e invalidëve të luftës së UÇK-së, pasi që Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së ka 70 anëtarë me shkallën e invaliditetit mbi 81 për qind, çka do të thotë se janë të paaftë për t'u pajisur me

patentshoferë, janë të paaftë për vozitje dhe kanë përcjellës të cilët paguhen nga Qeveria e Republikës së Kosovës për t'u kujdesur dhe për t'i përcjellë invalidët", është thënë në reagimin e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së.

Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së ka njoftuar se disa herë ka dorëzuar kërkesa në Ministrinë e Financave që të ndryshohet kjo dispozitë ligjore dhe të hiqet kushtëzimi diskriminues që ka të bëjë me patentshoferë për invalidët e luftës së UÇK-së. "Në këtë shoqatë ka anëtarë që janë të verbër në të dy sytë, kanë të amputuara duart dhe këmbët dhe e kanë të pamundshme pajisjen me patentë të shoferit për shkak të paaftësive fizike si rezultat i luftës për lirinë e vendit tonë. Kemi kërkuar që invalidi pas pesë vjetësh që ka përdorur automjetin ta ketë të drejtën e tjetërsimit dhe të lirohet nga të gjitha detyrimet doganore", është thënë në komunikatën për media të kësaj shoqate.

Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së i ka bërë thirrje publike presidentit, kryeparlamentarit dhe kryeministrit që të angazhohen urgjentisht për pezullimin e këtij udhëzimi administrativ si dhe për heqjen e këtyre dispozitave diskriminuese që parashihen me nenin 7 dhe 9 të këtij udhëzimi



administrativ. Gjithashtu, kjo shoqatë e luftës ka bërë thirrje që të formohet një komision ndërqeveritar në të cilin duhet të jetë e përfshirë edhe Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së

për nxjerrjen e udhëzimit administrativ për procedurat e realizimit të të drejtave në lehtësime doganore dhe tatimore për invalidët e luftës së UÇK-së. Shoqata e Invalidëve të Luftës së

UÇK-së ka bërë me dije se do të vazhdojnë procedurat ligjore për shfuqizimin e këtij udhëzimi administrativ, duke mos përjashtuar edhe mundësinë e protestës.

## Procedohet për Kuvend iniciativa për themelimin e Komisionit Hetimor për Veteranët e UÇK-së

**EPOKA ERE** **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 12 KORRIK - Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës në mbledhjen e së premtes ka proceduar për në Kuvend propozimin e kryetarit Kadri Veseli, mbështetur nga shtatë deputetë të tjerë, për themelimin e Komisionit Hetimor në lidhje me veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ndërsa Projektligji për Komisionarin Parlamentar për Forcën e Sigurisë, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Projektligji për ndryshimplotësimin e Ligjit për Automjete nr. 05/L-132, si dhe Projektligji për Kuvendin e Republikës së Kosovës janë proceduar për mendim në qeveri. Ndërkohë dy projektligje të tjera, ai për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur, si dhe Projektligji



për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-004 për Presidentin e Republikës së Kosovës, janë proceduar për shqyrtim në komisionin

përkates funksional dhe do t'u shpërndahen deputetëve. Po në këtë mbledhje kryesia është njoftuar me raportin e auditimit për Kuvendin e Republikës së Kosovës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018,

ndërsa ka miratuar raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2019 si dhe rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për

vitin 2020-2022, në bazë të Qarkores së Parë Buxhetore të Ministrisë së Financave 2020/01. Kryesia e Kuvendit në këtë mbledhje ka shqyrtuar edhe çështje të tjera nga fusha administrative.



Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka mbajtur konferencë për media

## Tahiri: Së shpejti nisë rekrutimi i noterëve

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë se qasja në drejtësi është imperativ i patjetërsueshëm dhe shumë shpejt do të nisë rekrutimi i noterëve të rinj. Sa i përket rrjedhës së provimit të noterisë, ai ka theksuar se çdo gjë ka qenë e organizuar në mënyrë profesionale dhe kredibile. Sipas Tahirit, kërkesa për pezullimin e këtij aktiviteti profesional e të bazuar në ligj është tërësisht politike dhe ka pasur për qëllim kohëzgjatjen e monopolit në këtë fushë



**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 12 KORRIK** - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka mbajtur të premten një konferencë për media, së bashku me dy anëtarë të komisionit për provimin e noterisë, në të cilën ka sqaruar për opinionin publik rrjedhën e organizimit dhe mbajtjes së këtij provimi. Ministri Tahiri ka vlerësuar se ky proces e ka origjinën në reformat që janë paraparë me ligjin e ri për noterinë i cili ka hyrë në fuqi në fillim të vitit 2018. "Në qendër të reformës që kemi realizuar ka qenë adresimi i sfidave të sistemit noterial në raport me shërbimet ndaj qytetarëve. Përkundër faktit se këto shërbime janë ofruar nga noterët, karakteristikat e përgjithshme të kësaj fushe para hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë qenë se jo të gjitha qytetet kanë pasur noterë, jo të gjitha

komunitetet kanë pasur noterë, ka pasur nevojë për ta zgjeruar fushën e veprimit të noterisë në çështje vitale për qytetarët, siç është çështja e trashëgimisë dhe mungesa e numrit të mjaftueshëm të noterëve, në raste të caktuara ka nxitur një praktikë të thellë të monopolit në këtë fushë", ka thënë ministri Tahiri.

Ai ka shtuar se për t'i tejkaluar këto situata, me Ligjin e ri për Noterinë është paraparë, mes të tjerash, rritja e numrit të noterëve sipas formulës së re 1 noter në 10 mijë banorë. Sa i përket rrjedhës së provimit të noterisë, ministri Tahiri ka specifikuar se që nga përzgjedhja e komisionit vlerësues, sipas parametrave të përcaktuar me ligj e deri tek siguria e plotë e konfidentalitetit të testiut, çdo gjë ka qenë e organizuar në mënyrë profesionale dhe kredibile. "Ka pasur kritere aq rigorozë të vlerësimit sa që

krahasimi i numrit të atyre që i janë nënshtruar provimit dhe atyre që përfundimisht kanë dhënë provimin e noterisë është instrument objektiv i matjes. Ky është standard i ri që shumëkush mund të mos jetë mësuar, por ja që kur ka vullnet për t'i bërë gjërat në mënyrë profesionale, gjërat janë të mundshme", ka thënë Tahiri. Ai ka treguar se tani e tuje vazhdon faza për rekrutimin e noterëve, sipas përcaktimit të paraparë në ligj. "Qasja në drejtësi është imperativ i patjetërsueshëm dhe shumë shpe-

jt do të nisë rekrutimi i noterëve të rinj" ka thënë ministri Tahiri. Ministri Tahiri ka adresuar edhe komentet që kanë qenë subjekt i raportimeve në media rreth çështjes së provimit të noterisë. Ai ka theksuar se konkursi ka qenë publik, i hapur për të gjithë qytetarët që kanë plotësuar kriteret preliminarë dhe se askush nuk është inkurajuar e as dekurajuar të aplikojë për provim. "Kur një gjë të tillë nuk e ndalon ligji, mbi çfarë baze mund t'ua ndalosh individëve të lirë të

kësaj shoqërie që të marrin pjesë në garë", ka deklaruar Tahiri. Sipas ministrit Tahiri, kërkesa për pezullimin e këtij aktiviteti profesional e të bazuar në ligj është tërësisht politike dhe ka pasur për qëllim kohëzgjatjen e monopolit në këtë fushë. "Përballë këtij fakti, dëshiroj të sqaroj për ju dhe gjithë opinionin publik se si ministër i Drejtësisë shërbej për dy milionë qytetarë e jo për miliona euro të atyre që kanë monopol në fushën e noterisë", ka thënë ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri.

## UNDP-ja ia dhuron Policisë së Kosovës 36 kompjuterë

**PRISHTINË, 12 KORRIK (ER)** - Policia e Kosovës ka pranuar të premten 36 kompjuterë nga UNDP-ja. Këta kompjuterë janë dhuruar me qëllim të lehtësimit të punës për vazhdimin e fushatës për regjistrimin e kërkesave për legalizimin e armëve, në mënyrë që të nxitet dhe forcohet siguria në vend. Legalizimi i armëve është një nga metodat më të mira për zvogëlimin e numrit të armëve të paligjshme, në të njëjtën kohë u mundëson qytetarëve të kenë armë në përputhje me ligjin. Këta kompjuterë do të shpërndahen në 36 stacione policore dhe të njëjtat do të përdoren nga personeli për regjistrimin e kërkesave për legalizim të armëve. Kjo ngjarje është mbajtur të premten në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, ku në mesin e të pranishmëve kanë marrë pjesë zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi

Zeka, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, dhe përfaqësuesja e Përhershme e UNDP-së, Maria Suokko. "Më duhet të theksoj se deri më tani jemi jashtëzakonisht të kënaqur me nivelin e lartë të vetëdijes dhe gatishmërisë së qytetarëve për të shfrytëzuar këtë mundësi për legalizim të armëve të paligjshme. Vlerësoj lart angazhimin profesional të Policisë së Kosovës për një punë të shkëlqyeshme në zbatimin efikas të fushatës për legalizimin e armëve të paligjshme si dhe dëshiroj ta falënderoj për bashkëpunim dhe përkrahje UNDP-në e cila përmes këtij donacioni të kompjuterëve përkrahë Ministrinë e Punëve të Brendshme, respektivisht Policinë e Kosovës, që zyrtarët policorë në stacione policore, të cilët merren me pranimin e kërkesave nga qytetarët për legalizim të armëve, të ofrojnë



shërbime sa më të shpejta dhe cilësore", ka thënë zëvendësministri Zeka. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka falënderuar UNDP-në për përkrahjen e vazhdueshme

që ka dhënë për policinë. Përfaqësuesja e Përhershme e UNDP-së, Maria Suokko, ka përgëzuar punën e institucioneve në fushën e sigurisë. "Dua t'i përgëzoj autoritetet e Kosovës që të parët në rajon

miratuan strategjinë dhe planin e veprimit për armët e vogla dhe të lehta. UNDP-ja do të vazhdojë të ofrojë mbështetje të plotë për zbatimin e veprimeve të planifikuara", ka thënë Suokko.



# Trusti: Mbi 100 milionë euro rritje nga investimet për gjashtëmujorin e parë

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKP) e ka përmbyllur gjysmëvitin e parë 2019 me kthim bruto mbi 100 milionë euro nga investimet. "Tregjet gjatë këtij gjashtëmujori kanë qëndruar në kuota pozitive, edhe pse kishte disa tronditje të forta në tregjet financiare, posaçërisht në muajin maj", është thënë në njoftimin e FKP-së



EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 KORRIK - Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKP) e ka përmbyllur gjysmëvitin e parë 2019 me kthim bruto mbi 100 milionë euro nga investimet. Tregjet gjatë këtij gjashtëmujori kanë qëndruar në kuota pozitive, edhe pse kishte disa tronditje të forta në tregjet financiare, posaçërisht në muajin maj. "Treguesit ekonomikë dhe ata të afarizmit të korporatave ishin inkurajues për investitorët. Ndërkohë kishte edhe një zbutje në luftën tregtare mes fuqive të mëdha. Megjithatë, rreziku i përke-

qësimit të tensioneve politike vazhdon të jetë aktual, për çka do të duhet një vigjilencë e shtuar për ta ruajtur nivelin e vlerës së ngritur edhe në gjashtëmujorin e dytë të vitit, i cili do të jetë sfidues për shkak të luhatshmërive në tregjet financiare", është thënë në njoftim e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, duke u shtuar se në nën këto kushte Bordi Drejtues është duke ndjekur aktivisht lëvizjet dhe varësisht prej pritshmërive është duke bërë alokimin taktik mbrojtës të mjeteve. "Tashmë Bordi e ka shtuar edhe një fond të ri investues (BlackRock - iShares Edge S&P 500 Minimum

Volatility Euro Hedged) me qëllim menaxhimin sa më të mirë të luhatjeve në tregjet financiare. Po ashtu, Bordi vazhdon të jetë i përkushtuar për shtimin e investimeve në Kosovë, brenda mundësive të përcaktuara ligjore. Investimi i më shumë mjeteve në depozitat bankare është në proces e sipër, ndërsa

vazhdon pjesëmarrja në të gjitha ankandet e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës", është në njoftimin e FKP-së. Sipas këtij njoftimi, me këto lëvizje tejet pozitive në investime, por dhe me kontributet e reja, mjetet nën menaxhim u shtuan për rreth 180 milionë euro këtë periudhë, për të arritur

në 1 863 milionë euro. "Rreth 24 për qind e këtyre mjeteve ishin në Kosovë, kurse pjesa tjetër (76 për qind) ishin të investuara në tregjet financiare. FKP-ja prej themelimit dhe deri më 30 qershor 2019 ka kthim bruto nga investimet prej 450 milionë eurosh", është theksuar në njoftimin e FKP-së.

## Ministria e Bujqësisë investon në sistemin e ujitjes në Malishevë



PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të investojë në rehabilitimin dhe zgjerimin e sistemit të ujitjes në Komunën e Malishevës me qëllim të rritjes së rendimenteve në prodhimtarinë bujqësore dhe në zvogëlimin e dëmeve të mundshme që shkaktohen nga temperaturat e larta dhe thatësira. Për realizimin e këtij projekti Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi me Komunën e Malishevës për ta mundësuar kështu ndërtimin e kanalit të ujitjes në fshatin Banjë të kësaj komune. Me këtë rast, ministria e

MBPZHR-së, Dijana Ziviq, ka treguar se deri më tash kjo ministri ka arritur të ndërtojë kanale të ujitjes dhe të zgjerojë shumë sisteme ekzistuese nëpër të gjitha komunat e Kosovës e këto investime ajo tha se do të vazhdojnë t'i bëjnë në vazhdimësi edhe në vitet e ardhshme. "Përfshirja e sipërfaqeve të reja nën ujitje përbën prioritet për ministrinë dhe investimet për rregullimin e sistemeve të ujitjes do të vazhdojnë të bëhen edhe në të ardhmen", ka thënë Ziviq. Ndërsa Ragip Begaj, kryetar i Komunës së Malishevës, ka vlerësuar këtë projekt, duke thënë se investimet e tilla janë të domosdoshme për zhvillimin e bujqësisë në këtë komunë.

## ATK-ja dhe AKP-ja koordinohen për bashkëpunim

PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, ka pritur të premtën në takim drejtorin menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Valon Tolaj, me bashkëpunëtorët e tij. Në këtë takim u diskutua për bashkëpunimin e deritashëm si dhe për thellimin e bashkëpunimit në mes të ATK-

së dhe AKP-së me qëllim të rritjes së efikasitetit gjatë proceseve të punës. Drejtuesit e dy institucioneve e vlerësuan lart bashkëpunimin e deritashëm për funksion të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit, për zhvillim të procedurave adekuate ligjore, për trajtimin e kërkesave për lirin dhe transferimin e barrës tatimore të ndërmarrjeve

shoqërore (NSh) nga regjistri i pasurive kadastrale në llogarinë e fondit të mirëbesimit, për ofrimin e të dhënave për shitjen e pasurive të ndërmarrjeve shoqërore (NSh) si dhe për shlyerjen e borxheve tatimore të ndërmarrjeve që janë nën autoritetin e AKP-së. Të dyja palët u pajtuan të angazhohen për ruajtjen dhe rritjen e bashkëpunimit në mes



këtyre dy institucioneve, në funksion të transparencës dhe efektivitetit të shërbimeve, zbatim të barabartë dhe të njëtrajt-

shëm të ligjit, si dhe angazhim për kushte më të mira për veprimtarinë e përmbylljes tatimore.



# Kryeministri nis sezonin e korrje-shirjeve



Kryeministri Ramush Haradinaj ka vizituar të premtën Komunën e Kamenicës, me ç'rast është takuar me fermerë dhe bujq. Haradinaj, i shoqëruar edhe nga kryetari i kësaj komune, Qëndron Kastrati, në fshatin Kopërnice ka nisur sezonin e korrje-shirjeve

**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

Kamenicë, 12 korrik - "Arsyeja pse jemi këtu është që të dërgojmë porosi, se jemi të vetëdijshëm që prodhimi është ai që do ta mbajë popullsinë në vend", ka thënë kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, pas vizitës që bëri të premtën në fshatin Zajqec të Komunës së Kamenicës. Fillimisht, kryeministri Haradinaj ka vizituar fermën e lopëve të fermerit Blerim Aliu në fshatin Zajqec, i cili është përfitues i programeve mbështetëse nga Qeveria e Kosovës. Kryeministri Haradinaj me këtë

rast, pasi ka përgëzuar fermerët për punën që kanë bërë dhe po bëjnë në vazhdimësi, inkurajoi që të vazhdojnë me këtë ritëm, duke e pasur gjithmonë përkrahjen e tij dhe të qeverisë që drejton për të siguruar kështu zhvillim të prodhimit vendor dhe vende të reja të punës. "Fermerët si Blerimi kanë arritur ta ruajnë traditën, të prodhojnë produkte vendore të cilësisë së lartë, duke punësuar njerëzit tanë dhe duke i dhënë shtysë ekonomisë së vendit", ka thënë kryeministri Haradinaj. Fermerët, ndërkaq, kërkuan mbështetjen edhe për finalizimin e disa projekteve të kësaj ane. Po në Zajqec të Kamenicës, kryeministri Haradinaj ka viz-

ituar edhe fabrikën e ujit "Zajqeci", duke u shprehur që ky investim, i një bashkatdhetari që ka punuar në Zvicër, është një investim domethënës, sepse e ka bërë në vendlindjen e tij dhe është veprimtari prodhues, pra ujë. "Fabrika e ujit 'Zajqeci' është dëshmia më e mirë e një kompanie vendore që ka shënuar sukseset e saj me cilësi të lartë. Inkurajues fakti që një bashkatdhetar yni, Rrahim Imeri, që ka jetuar dhe punuar në Zvicër, ka zgjedhur atdheun e tij që të investojë dhe t'i ndihmojë zhvillimit ekonomik të vendit, me fabrikën e avancuar që i plotëson standardet dhe pritshmërinë e qytetarëve. Gjatë vizitës në këtë fabrikë shpreha

zotimin që si qeveri e vendit do të qëndrojmë krahas kompanive vendore që bashkërisht t'i japim dimension tjetër zhvillimit ekonomik", ka thënë kryeministri Haradinaj gjatë vizitës në këtë fabrikë.

Bashkë me kryetarin e Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka zhvilluar një takim edhe me fermerët në plantacionin e arrës, në fshatin Kopërnice të Komunës së Kamenicës, gjithashtu përfitues të programeve mbështetëse nga Qeveria e Kosovës, ku në një hapësirë prej 50 hektarësh janë mbjellë fidanë arre, me pretendimin që të vazhdohet me një kapacitet deri në 70 hektarë. Në të ardhmen, sipas fermerëve, pretendohet të hapet edhe një fabrikë për përpunimin dhe grumbullimin e arrës. Kryeministri Haradinaj ka thënë se është inkurajues fakti që ka përpjekje për të punuar në këto zona dhe se me guxim po ndod-

hin disa investime. "Mbjellja e 15 mijë fidanëve të arrës është një rast i guximshëm", është shprehur kryeministri Haradinaj, duke falënderuar investitorët për këtë hap, por edhe është interes i të gjithëve që të vazhdohet me tutje përkrahja e fermerëve dhe investuesve.

Në këtë fshat kryeministri Haradinaj bëri edhe hapjen e fushatës së korrje-shirjeve me ç'rast, pasi uroi për fillimin e korrje-shirjeve, ka thënë se ka qenë traditë që kjo ngjarje të konsiderohet si një porosi, që jetën duhet krijuar në vendin tonë. "Uroj që sa më shumë sipërfaqe të Kosovës të mbillen jo vetëm me grurë, por edhe me drithëra të tjerë", ka thënë Haradinaj.

Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka thënë se është kënaqësi që janë këtu dhe ka uruar të shkojë mbarë e të ketë prodhim toka.

## Mehmeti dhe Zeka diskutojnë për zhvillimet në sektorin financiar

PRISHTINË, 12 KORRIK (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka pritur të premtën në takim përfaqësuesit e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, të përfaqësuar nga drejtori ekzekutiv Arian Zeka, Kujtim Gjevori dhe Ardian Hoxha.

Duke shprehur falënderimin për vizitën në Bankën Qendrore

të Republikës së Kosovës, guvernatori Mehmeti ka njoftuar përfaqësuesit e Odës Ekonomike Amerikane për zhvillimet e fundit në sektorin financiar të vendit, në veçanti në sektorin bankar, i cili vazhdon të performojë mirë, duke nënvizuar rritjen e aktivitetit të këtij sektori në mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit dhe shkallën e lartë të qëndrueshmërisë që

gëzon ky sektor.

Nga ana tjetër, përfaqësuesit e Odës Ekonomike Amerikane kanë shprehur nevojën për rritje të mëtejme të përkrahjes nga ana e sektorit bankar për sektorin privat dhe lehtësim të qasjes në financa, veçanërisht për sektorët me projekte zhvillimore, të cilët kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit.





## Mbyllen katër bastore në Ferizaj

FERIZAJ, 12 KORRIK (ER) - Inspektorati i Komunës së Ferizajt, i ndihmuar edhe nga Policia e Kosovës, kanë mbyllur

katër bastore në qendër të kësaj komune të cilat po operonin ilegalisht në kundërshtim me vendimin për ndalimin e lojërave

të fatit si dhe ligjit për këtë çështje. Mbyllja e bastoreve dhe kazinove në territorin e Ferizajt tashmë

është një aksion i filluar shumë muaj më parë dhe po vazhdon me ritëm më të lartë veprimi nga inspektorati i kësaj komune.



## Vihet gurthemeli i xhamisë në fshatin Shupkovc të Mitrovicës



MITROVICË, 12 KORRIK (ER) - Të premtën është bërë vënia e gurthemelit të xhamisë në fshatin Shupkovc, iniciativë e ndërmarrë nga qytetarët, Bashkësia Islame dhe me mbështetje të Komunës së Mitrovicës. Me rastin e vendosjes së këtij gurthemeli ishte i pranishëm kryetari i komunës, Agim Bahtiri, zëvendësministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Gjergj Beka, kryetari i Bashkësisë Islame në Mitrovicë, Irfan Krasniqi, drejtori për Urbanizëm, Besnik Beka, drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, Nehat Bahtiri, përfaqësues nga Bashkësia Islame dhe banorë të këtij fshati. Në fjalën e tij kryetari i komunës, Agim Bahtiri, ka uruar vënien e gurthemelit të

xhamisë në fshatin Shupkovc, duke thënë se ndërtimi i kësaj xhamie si një shtëpie e Zotit do të sjellë vetëm paqe dhe harmoni për banorët e kësaj fshati. Po ashtu, kryetari Bahtiri ka theksuar se që nga fillimi e deri më sot xhamitë kanë pasur një rol qendror për pastrimin shpirtëror të shoqërive dhe bashkimin mes njerëzve, duke shtuar se xhamitë janë edhe vende ku mësohet drejtësia, dashuria, mëshira dhe respekti. Ndërsa kryetari i Bashkësisë Islame, Irfan Krasniqi, në emër të Këshillit të Bashkësisë Islame ka falënderuar kryetarin Bahtiri për mbështetjen e tij, duke thënë se vënia e këtij gurthemeli të kësaj xhamie do të shërbejë për një edukim të mirëfilltë fetar.

## Malisheva bëhet gati për pritjen e mërgimtarëve

MALISHEVË, 12 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Besartë Kryeziu-Ramaj, kanë pritur të premtën në një takim informues Komitetin për Diasporë, organ i Kuvendit Komunal, lidhur me organizimet dhe aktivitetet për pritjen e mërgimtarëve, në veçanti për "Javën e Diasporës". Kryetari Begaj dhe drejtoresha Kryeziu-Ramaj i kanë informuar anëtarët e komitetit për organizimet që planifikohen për pritjen sa më të mirë të mërgimtarëve si dhe për masat e tjera për ofrimin e shërbimeve sa më efikase dhe më të mira për mërgimtarët, në të gjitha fushat e mundshme.

Bazuar në deklaratimet në këtë takim është bërë me dije se në kuadër të javës së diasporës do të jenë disa organizime kulturore,

duke filluar me aktivitetin më të madh, mbajtjen e edicionit të gjashtë të Festivalit Folklorik Mbarëkombëtar "Oda e Llapushës", panairi artizanal, përrurime librash, pastaj organizimi i një takimi apo pritje për mërgimtarët.

Po ashtu, është bërë me dije se nga 15 korriku parkingu i komunës do të jetë tërësisht në shërbim të mërgimtarëve, pastaj masat e tjera për ofrimin e shërbimeve që kërkohen nga komuna, shërbime publike dhe të tjera.

Edhe anëtarët e komitetit kanë kërkuar që të ketë aktivitete të tjera shtesë, në mënyrë që të plotësohen nevojat e mërgimtarëve gjatë qëndrimit të tyre në vend, duke përfshirë masat në trafik, furnizim 24 orë me ujë, shërbime më të shpeshta të grumbullimit të mbeturinave dhe masa në ofrimin e shër-



bimeve shëndetësore. Për të gjitha këto, kryetari Begaj ka thënë se do të jetë në dispozi-

cion të mërgimtarëve. Gjithashtu, sipas tij, edhe stafi i administratës dhe qeverisë

komunale do të jenë të mobilizuar për ofrimin e të gjitha këtyre shërbimeve.

## Kamenica dhe KPMM-ja bashkërendojnë aktivitetet kundër operatorëve të palicencuar



KAMENICË, 12 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit, Ramadan Basha, dhe përgjegjësi i Inspektoratit, Liridon Beqiri, kanë pritur të premtën në takim kryeinspektorin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), Fatmir Gërguri. Në takim është diskutuar për


rjedhën e aksionit për ndërprerjen e veprimeve ilegale të operatorëve të palicencuar, i zhvilluar ditë më parë në Komunën e Kamenicës. Një aksion i tillë është cilësuar shumë i suksesshëm dhe se bashkërendimi në mes të Komunës së Kamenicës dhe KPMM-së do të thellohet në vazhdimësi me qëllim që të mos lejohen operime ilegale dhe të ndërpritet përgjithmonë degradimi i lumenjve dhe mjedisit në përgjithësi.



Diplomatët që e shkëlqejnë epokën e bacë Adem Demës, ose për një vepër që është më shumë se diplomaci e më pak se politikë (3)

## Trimi i mirë me shokë shumë

(Sabri Kiçmari, "Fitorja diplomatike: kujtime nga përfaqësuesi diplomatik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", "Epoka e re", Prishtinë, 2017)



Prof. dr. Hakif BAJRAMI

Në vijim diplomati ynë Sabri Kiçmari argumenton shkoqur në librin e tij, se Rambuje ka vdekur përfundimisht si marrëveshje në maj 1999. Në këtë hapësirë lexuesi që merret me "pedagogji" intelektuale, por jo ai që merret me histori të thikave serbiane, mund të mësojë shumë diplomaci të navigacionit logjik nga shprehjet antologjike të kryedipomatit gjerman Joshka Fisher: "Kurrë ma Aushvic, kurrë ma luftë dhe fashizëm" (f. 239). Nga ky prononcim nxjerrim një konkluzë se deri atëherë kur Serbia fashiste dje, sot e besa edhe nesër, nuk do t'i paguaj dëmet e luftës, politikanët e saj nuk do ta mallkojnë fashizmin serbian si Joshka Fisher atë të Hitlerit. Nga kjo aksiomë del një pyetje: A ishte Sllobodan Millosheviqi një Hitler Ballkanik, kur ai i Luftës Dytë, ishte vrasës botëror. Përgjigje logjike dhe faktike është - Po. Atëherë, deri kur do ta përkëdhelë BE-ja aleatin e Ruisë-Serbinë, është pyetje e pyetjeve dje, sot dhe mbetet pyetje kujdestare edhe për nesër. Këtë përgjigje e dinë vetëm ata që përipiqen djallin ta izolojnë në shishe, e shishe askund nuk ka, sepse vet po i thyejnë "shishe", me rregullat e mosdënimit të gjenocidit. Po e them këtë, sepse bota e civilizuar nuk është e kënaqur me verdiktin e Tribunalit të Hagës, si nuk do të jetë e kënaqur edhe me Gjykatën Speciale raciste, që është kurditur për ta defaktorizuar luftën e drejtë të UÇK-së. Dhe po ndodhë kjo ndrydhje politike dhe gjyqësore kundër UÇK-ës me të vetmin qëllim që shtetësia e Kosovës të relativizohet. Më 21 maj 1999, Sabri Kiçmari ua bën me dije si intelektual i shkolluar kancelarive Evropiane dhe Lindore se shqiptarët nuk do të çarmatosen ma kurrë. Pikërisht në këto rrethana autori e plasoi një rrëfim të Ibrahim Rugovës kur thotë: "Kosova me luftën e UÇK-së nuk ka shans të çlirohet". Këtë e thotë në atmosferën kur në prill 1999 ishte takuar me Milloshin, Çernomirdinin, Millutinoviçin, popin Pavle e Aleksiev, Shainoviç etj. Duke shtuar kobshëm se: "Nëse vendoset një forcë ndërkom-

bëtare në Kosovë, me vendim të OKB (lexo Rezolutën. 1244), atëherë UÇK-ja është e panevojshme të mbetet si ushtri"!!! (f. 249). Nga ky qëndrim lindi ideja që UÇK-ja të shndërrohet në "shoqëri të zjarrfikësve", pa guxuar të merret me çështje ushtarake, dhe kjo "profeci" ka ndodhë.

Nga ky përshkrim diakronik autori pason së përshkuari takimin me Lary Rosin, për të peshuar në studim tragjedinë e një milion refugjatëve shqiptarë, duke provuar ta nxjerr këtë masë popullore nga humnera përmes themelimit të një Këshilli për Siguri Kombëtare (2 VI 1999). Autori i ka mbetur borxh lexuesit (e nëse e riboton studimin duhet ta plotësojë), lidhur mega takimin e Hashim Thaçit, Ibrahim Rugovës dhe Rexhep Qosjes më 8 VI 1999 në Këln, me regjinë e M. Albrihtit, për ta nxjerr një platformë që valorizon pasurinë e Bujar Bukoshit me "pushtetin" e Hashim Thaçit, si kryetar qeverie, fakt ky i kuptuar mes rreshtave.

Autori në këtë studim na e sjell profilin politik jo diplomatik të një diplomati që quhet Albert Roahn e i cili me Bernard Kushnerin kanë çka thonë prapa perdeve për fatin e Kosovës dhe disa gabime që e përcjellin shtetësinë e këtij vendi të përgjakur edhe sot, pa i harruar prapaskanat e Lary Rossit, prej të cilave Kosovës nuk i vjen era pavarësi, por ngrirje në Rezolutën 1244 të KS OKB, si dhe një "alienim" të Kosovës në veri të lumit Ibër, ku ka gisht edhe

shërbimi i një shteti frankofon. Sabri Kiçmari duke u kthyer në Kosovë përmes Durrësit e ka mendjen dhe instiktin plotë vuarjtje refugjatësh shqiptarë, tragjedi kjo që shënonte fundin e një gjenocidi të programuar nga neofashizmi serbian. Autori e ngrohë shpirtin dhe zemrën në Prishtinë më 22 VI 1999, duke kërkuar që të peshojë më shumë se plumbi mbi supet e tij në Zonës Operative të Llapit, Zonë kjo që e pati zgjeruar "kufirin edhe në Prishtinë-Kosovë", për t'u bërë pastaj ambasador i vërtetë i saj, Kosovës, në Austri dhe Australinë e largët.

Tash ambasadorit të nderuar prof. dr. Sabri Kiçmarit, i dëshirojmë shëndet dhe jetë të gjatë në punën më të çmuar në ligjërimin universitar, ku korret gjithmonë bereqeti më i ëmbël njerëzor civilizues, duke mos e harruar zanatin e diplomatit nëse e angazhojnë ata që mbajnë fate intelektualësh në shuplakën e një dore. Respekt, por jeta më e dliër, buka më e ëmbël është ajo intelektuale arsimore. Aty prof. dr. Sabri Kiçmari e ka frontin e hapur, e ka vendin e sovranit, që studentëve të tij t'u dhuroi dituri, sepse e meritojnë, sepse profesori Sabri ka edukatë, ka dituri t'i mësojë.


Të përfundojmë, me pyetjen se çka kemi mësuar deri me sot për ta forcuar Kosovën me shkollë diplomatike, madje edhe nga ky publikim. Kemi mësuar mu ashtu si sillej presidenti Rugova, që shihte por nuk dinte, sepse pikërisht në mars-qershor 1999, ishte i rrethuar me teknokrat,

madje injorantë. E sot presidenti Hashim Thaçi, po mendon se ka dituri, por realisht nuk po sheh asgjë, përtej bregut, sepse e kanë rrethuar teknokratët e germave malinje, madje me paskrupullti po kërkon "korrigjim të kufijve", pa qenë i vetëdijshëm se Beogradit po i bëhet argat me korrespondencë, të cilën e drejton në hije edhe pas zgjedhjeve për BE-në Frederika Mogerini dhe Hanni matuf dhe dinak, duke na dëshmuar se: Larg kanë shkuar, rruga e tyre ka qenë mjaftë e gjatë, ma në fund u kuptua se kanë lëvizur në rreth të thatë, të cilit rrethi ka pri herë në terr e herë në pike të ditës Edi Rama, duke menduar se lumi i Drinit shkon për Prishtinë, e jo kah e ka rrjedhën natyrale. Mu në këtë nyje duhet të shpjegohet se Rezoluta 1244 e KS OKB-së e ka lënë jashtë 'lojës' triumfin e UÇK-së në Koshare dhe Pashtrik. Sepse po të lejohej UÇK-ja të marshonte sigurisht se Serbia fashiste nuk do ta nxirrte ushtrinë dhe teknikën nga Kosova triumfalisht si u lejua. Në këtë rrafsh realiteti, edhe sot, dështimi i Samitit Parisit më 1 korrik 2019, nuk është faji as i Ligjit për Trepçën, as i Ligjit për ushtrinë, as i taksës së Ramush Haradinajt, por është thjeshtë dështim që vjen nga dallimi në konceptin për zgjidhjen e çështjes së Kosovës Veriore, në mes Berlinit dhe Parisit.

E presidenti Hashim Thaçi shumë ulët nxitoi ta akuzoi Qeverinë e Kosovës për dështim të samitit. Ky pozicionim më bëri që ta krahasoi sjelljen e Ibrahim

Rugovës dje dhe sjelljen e Hashim Thaçit sot. Përndryshe ndaj as njërit, nuk kam asgjë personale.

E vepra e prof. dr. Sabri Kiçmarit e ka një vlerë të veçantë, se rreshton lexuesin dhe studiuesin natyrshëm kah rrjedh uji, kah fitohen informatat dhe forcohet fitorja, garantohet pavarësia e Republikës Kosovës. E përballë tërë këtij arsenali fitoresh, në një mënyrë nuk u shfrytëzua pas çlirimit. Po e shënojmë atë plagën më eklatante e që drejtë për drejtë, nuk ka të bëjë me librin e parë diplomatik të prof. dr. Sabri Kiçmarit. Për çka është fjala. Jo vetëm sot, por qe dy vite është kah ngarkohet diplomacia dhe politika shtetërore e Republikës Kosovës, me korrigjim të kufijve, që do të shkaktojë një shkallëzim zingjiror problemesh, madje deri te lëvizja e popullsisë. E ky qëndrim le të vjen prej kujtdo qoftë, është thjeshtë diskualifikim i krimit, gjakut të derdhur për liri të Kosovës; e ky qëndrim edhe pse në politikë nuk ka gjëra të moralshme, nuk është i moralshëm, sepse e fut, deshëm ose jo në pazar, tërë sovranitetin e Kosovës. E këtu aspirojnë Aleksander Vuçiqi, I. Daçiçi me Putinin e Mogerinin, sepse pastaj as që ka shans të flitet për ndëshkim të krimeve, apo për reparacione të luftës, për të pagjetur etj. që do të duhej të përgjigjet dhe paguar Serbia fashiste dëmet kolosale në njerëz dhe pasuri ekonomike, kulturore dhe civilizuese për dhjetë vjet 1989-1999. (Fund)





# POEZIA E RISEMANTIZIMIT TË KODIT EROTIK TË LULZIM TAFËS

(Disa fjalë për librin me poezi "Flirt" të autorit Lulzim Tafa, botuar nga AAB, Prishtinë, 2019)



Shkruan: Sali BASHOTA

Pikënisja e shkrimit tim kritik dhe vlerësues për librin më të ri të Lulzim Tafës shënjohe pikërisht nga vargu i tij virtuoz: "Poezia është si Toka/Veç pak më e madhe". Nga këtu çdo gjë që ndërlidhet me aktin krijues, me frymëzimin dhe përbërësit e tij, me idetë dhe temat, ndër të tjera, e krijon parabolën dhe botën e poetit, sikur ta portretizonte, madje diku të gdhendur në kujtesën e lumtur dhe krenare të poetëve, mendimin brilant të Harold Bloomit, kur thoshte se: "Poezia është një thirrje profetike që meriton pa diskutim kurorën e letërsisë imagjinare".

Poezia e Lulzim Tafës i ka shenjat e veta të cilat e prodhojnë faktin estetik, për ta gjetur udhën dhe krijimin e dashurisë, pse jo identitetin e saj, pikërisht me gjuhën, stilin, figurat e renditura në një hapësirë të krijimit dhe të meditimit lirik, aty ku fuqizohen dhe e marrin primatin e vet semantik dhe simbolik një varg e vister figurash të mendimit dhe të fjalorit poetik, mirëpo ku triumfon bindshëm prania dhe domethënia e elipsës poetike nëpërmjet risemantizimit të kodit erotik.

Poeti edhe kur pohon edhe kur mohon e vë në funksion leksikon apo idiomën gjuhësore për t'i ikur kodifikimit, për ta fuqizuar mendimin dhe për ta saktësuar harmoninë e ndjenjës, të çastit, të situatës, në raport me aktin krijues. Është pikërisht gjuha poetike vetë formula e vizionit shkrimor lirik ku poeti e sjellë konceptin e vet në procesin e të menduarit, pse poezia së pari është ideal i shpirtit, ndërsa fjalori, fryma, porosia e saj i prodhon të amblat dhe të idhtat e jetës, aty ku ritmi i kënaqësisë, ritmi i zemërimit, ritmi i situatës etj., e kanë një emërues të përbashkët në realitetin e përjetuar të subjektit lirik se çdo gjë lind e jeton kur betohesh për "kry t'vargut", siç thotë poeti në poezinë e parë të librit "Akull dhe dashni".

Poezia e Lulzim Tafës është një monolog i shkathët që e ka rrjedhën dhe intensitetin e vet, i funksionalizuar me ngarkesë të veçantë ideoemocionale, madje monolog që, gjithashtu, e ka formën, bukurinë dhe qëllimin e

vet, i cili e kërkon dialogun e tjetrit, për ta saktësuar dramatisimin e situatave të shoshitura përbrenda këtij realiteti ekzistues, aty ku nëpërmjet pyetjeve të shpeshta sugjeshive kërkohet identiteti i qenies, herë në minimumin e mundshëm, herë në maksimumin e pamundshëm.

Në pesë ciklet e librit "Dashuri", "Flirt", "Lufta", "Bisedë me miq" dhe "Dhimbje", Lulzim Tafa i shfaq, i formëson dhe i ofron kërkimet e tij krijuese, në favor të trajtimit dhe ndriçimit të mozaikut të temave që ndërlidhen me shoqërinë, aktualitetin, luftën, religjionin, humanizmin, dashurinë etj. Dhe, pa dyshim, poezia e këtij poeti bëhet valë shpirtërore, në të cilën kryesisht dominon ideja, e shtresuar dhe e simbolizuar me mall, zjarr dhe dashuri.

Këta tre përbërës (malli, zjarri, dashuria) e ndërtojnë një gjuhë specifike të ligjërimit poetik (variant letrar i gegënishtes me idiomat gjuhësore të të folmeve të Kosovës), për ta shtresuar raportin e poezisë me gjuhën, ligjërimit dhe lexuesin. Për më tepër, besimi i poetit për një dashni fikse, i mënjanon konvenat dhe klishetë e të perceptuarit ndryshe për poezinë erotike, ku gjithmonë bukuria e vashës bëhet kryefigurë e simbol, si pavdekshmëri e shpirtit dhe jo ana tjetër që e ka misteriozitetin e vet, të ndrydhur me lirinë e mëkatit për të dashuruar vetëm përfytyrimin dhe shpërfytyrimin e aktit të veprimit.

Magjia e dashurisë, shpërthen, si në këto vargje të poetit: "Me shpirt/me trup/ me m'plue" ("Ty") apo "me m'përpi/me një frymëmarrje" ("Eh") apo "Më ke ndez/ Si zjarr/ dhe po ngrohesh me mua" ("Piromane") apo "Më vështron të tërin nga maja/ Derisa unë pres/ ujin me vlue" ("Nga maja"). Këto vargje shqiptohen e zbërthehen brenda një konteksti të ri semantik, edhe kur trazimi apo mërzia, në njërin anë, e përmbysin imazhin, apo kur përjetimi dhe adhurimi, në anën tjetër, doemos bëhen kaq të dallueshme, kaq shpirtërore deri te receptimi i poezisë me efektin estetik të saj. Prandaj, ky është një shembull i veçantë i ilustrimit të dashurisë, ku ndjeshmëria njerëzore sistemohet përbrenda bazamentit të ndjeshmërisë shkrimore, përmes thjeshtësisë poetike me vargje të shkurtra dhe me komunikim të gjatë.

A mund të jetë ky një ditari i dashnisë ku poeti e ka thurur zjarrminë e tij, për ta shpalosur

një botë që ikën me plot peripeci e kujtime nga vetvetja dhe që rikthehet në gjenezën e krijimit, bëhet art e dëshmi poetike sepse, tekefundit, "për t'ia thyer paswordin ëndrës" (varg i poetit), udhëtimi i jetës nuk e njej vdekjen, por e njej vetëm pavdekshmërinë. Sigurisht se kodi për të hyrë dhe zbërthyer botën e poetit është vetë çelësi i interpretimit për poezinë me tematikë të dashurisë, veçanërisht në poezitë "Të dua më shumë se Paulinën" dhe "Grue", kështu që vargjet e poezisë së fundit: "Zoti është dashtë/ Me të lënë të bukur/ Kështu siç je"/, e përcaktojnë qartë dimensionin semantik e estetik, ku bukuria bëhet edhe fenomen i artikuluar me konotacione metafizike.

Cikli i dytë me titullin "Flirt", i përfaqësuar me poezitë "Ashensori", "Në Sex Shoop", "Kur ti më thërret", "Kushti", poezia për Çarl Bukovskin etj., zhvesh gjuhën nga sfera e realitetit, e dekomponon përtej arsyes njerëzore, vetëm e vetëm për ta përmbysur mitin e trilluar, shkëputur nga konteksti i

jetës, kur është herë ankth shpirtëror e herë dëshirë erotike, madje deri te zhveshja figurative nga absurdi dhe ironia. Mbase mund të jetë një formulë ekstreme e rebelimit, në pikëtakim me të dashuruarit ndryshe, ku ka edhe zemërim, revoltë, mllef, duf, klithmë, sarkazëm, indiferencë, por edhe lavdi dhe madhështi.

Në ciklin e tretë me titullin "Lufta", shquhet poezia "Letër Bujar Tafës", pastaj poezia për fëmijët e pagjetur në luftën e ndodhur në Kosovë, "Svetlana dhe lufta", "Parisi", "Ata më thanë ik e unë ika" etj. Në këtë cikël të poezive ndërtohen imazhe dhe peizazhe në raporte kundërvënëse dhe krahasuese, ku dominojnë ironia, antiteza, paradoksi, si dhe loja e kundërloja me ngjarje dhe figura të ndryshme që i përkasin së kaluarës, por edhe aktualitetit.

Mbi të gjitha, poezia "Letër Bujar Tafës" është një ndër poezitë më të mira të këtij libri, por dhe ndër poezitë më esenciale në krijimtarinë poetike të Lulzim Tafës. Paradoksalisht, poeti imazhin e luftës e vë bren-

da ligjërimit ironik dhe situatës tragjike, këtë herë, për ta përcaktuar veprimin në një ambient, në të cilin trishtimi, ëndrra, lutja, vaji, frika, guximi, mëkati, krimi, vrasja, vdekja etj., secili e secila prej tyre e kanë gjëmën e vajin e vet në një ëndërr të papërfunduar.

Në ciklin e katërt me titullin "Bisedë me miq", shquhet poezia për poetin e ndjerë Basri Çapriqi. Është një rimarrje e ideve të Çapriqit në një poezi të tij për heronjtë dhe kurvat, dhe e funksionalizuar në një kontekst tjetër imagjinar, si mbindërtim poetik, për ta aktualizuar ironinë lirike deri në maksimum. Edhe në poezitë e tjera të karakterit përkushtues, siç janë: "Vetëm ora jote ecë" (kushtuar Jeton Kelmendit), "Nëse do të nisesh letër për Natashën" (kushtuar Ion Deaconeskut), "Këto leja një romi" (kushtuar poetit të ndjerë Kujtim Paçaku), si dhe në poezitë në formë dialogu me diellin, qiellin, detin, drunjtë, gurët, Lulzim Tafa reflektimin e tij personal poetik e fuqizon mjeshtërisht në kontekste të reja ligjërimore dhe figurative.

Gjithsesi, edhe cikli i pestë dhe i fundit me titullin "Dhimbje" dallohet me poezi të realizuara në nivelin poetik dhe estetik. Poezia me titullin "Paralajmërim për ata që do t'iu vdes Nana", artikulon ndjenjat, mendimet dhe rrethanat e poetit për ta konceptuar mungesën dhe dhimbjen si paralajmërim për të tjerët gjatë shpjegimit të vdekjes së Nanës, sikur vdes bota, madje paralajmërimi e fuqizon tekstin për ta përcaktuar simbolikën e kontekstit, pikërisht me priten e dhimbjes, sepse: "Pa Nanë/ Dita ish pa Diell/Nata ish pa Hanë". Poeti e dokumenton saktë imazhin e mungesës së Nanës përbrenda një sfondi të përjetuar me shpirt, aty ku gdhendet përjetësisht portreti i saj i shenjtë. Po kështu, kuptimi dhe domethënia e dhimbjes paraqitet në variante të ndryshme të përmallimit e të melankolisë, por edhe të vuajtjes njerëzore (poezia "Edhe ata që nuk i njohim vuajnë"), por edhe në relacione të tjera që e fuqizojnë porosinë për jetën, në besimin për Zotin dhe për fjalën e mençur që shndërrohet në poezi të bukur.

Poezia e Lulzim Tafës, me shqetësimin e tij ideoemocional dhe imagjinar, në pikëpamje të tematikës, stilit, gjuhës, figuracionit etj., shquhet për vlera poetike dhe estetike dhe, pa dyshim, sjell një ndjeshmëri të veçantë lirike në poezinë e sotme shqipe.





# MKRS-ja pasuron fondin e bibliotekave publike

Në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka bërë të premtën shpërndarjen e librave të botuar dhe të blerë nga MKRS-ja, donacion për 37 komuna të Kosovës dhe për bibliotekat komunale shqiptare jashtë kufijve të Kosovës

**EPOKA  
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 KORRIK - Në një ceremoni të organizuar në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka bërë të premtën shpërndarjen e librave të botuar dhe të blerë nga MKRS-ja, donacion për 37 komuna të Kosovës dhe për bibliotekat komunale shqiptare jashtë kufijve të Kosovës. Me këtë rast, ministri Gashi fillimisht ka thënë se përmes formave të ndryshme të subvencionit në vazhdimësi është punuar që t'u dilet në përkrahje bibliotekave komunale dhe institucioneve të tjera komunale të kulturës. "Donacioni që ne po e dorëzojmë sot është jo i vogël dhe vlerësojmë se është tejte cilësor, meqë librat që ne sot po i japim janë librat më të mirë që janë botuar gjatë vitit 2018. Këtë vlerësim e ka bërë një trupë profesionale siç është Këshilli i Librit, organ që funksionon në kuadër të Ministrisë së Kulturës", ka thënë ministri Gashi.

Ministri ka theksuar se shpërndarja e librave në bibliotekat komunale është një politikë e rëndësishme. "Përmes kësaj politike ne po bëjmë subvencionim të dyfishtë për librin ngaqë këta libra fillimisht përkrahen për botim dhe blihen nga shtëpitë botuese në Kosovës, me ç'rast përkrahen shtëpitë botuese dhe autorët, ndërsa të njëjtat shpërndahen në bibliotekat komunale ku u ofrohen më shumë lexuesve në tërë territorin e Kosovës", u shpreh ai. Po ashtu, ministri Gashi ka konfirmuar se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në mandatin e tij qeverisës e ka pasur prioritet rritjen e mbështetjes për librin, botuesit dhe bibliotekat duke theksuar rritjen e buxhetit. "Sot dua të përmend se, përveç buxhetit që ne ndajmë për botimin e



librit, botimin e revistave letrare dhe blerjen e librave të botuar nga shtëpitë botuese vendore, ne ndajmë buxhet për librin dhe bibliotekat edhe në thirrjet publike vjetore të Ministrisë që bëhen për subvencionimin e skenës kulturore. Dua t'ju siguroj se ne do ta vazhdojmë përkrahjen tonë për librin, bibliotekat dhe bibliotekarinë dhe do t'i mbesim përkrahësit më të mëdhenj të librit në vend",

ka thënë Gashi. Ndërkaq kryesuesja e Këshillit të Librit, Sabile Keçmezi-Basha, ka thënë se ministri Gashi po bën një punë të mirë me grumbullimin e përfaqësuesve të bibliotekave të Kosovës për t'i shpërndarë librat. "Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përmes Këshillit të Librit ka botuar libra të autorëve shqiptarë e të komuniteteve të të gjitha trevave, orientimeve politike, fetare, gjinore, letrare e estetike, duke u treguar e hapur ndaj prirjeve dhe pëlqimeve të ndryshme stilistike etj. si dhe letërsi botërore të vendeve e gjuhëve të ndryshme të të gjitha periudhave letrare", ka theksuar Keçmezi-Basha. Ajo ka përmendur se në vitin 2018 MKRS-ja ka financuar 11 revista me karakter kombëtar dhe regjional, botimin e 53 librave të autorëve të ndryshëm, ka bërë blerjen e 56 librave të autorëve kombëtarë dhe të huaj, ku totali i investimeve ka qenë 158 522 euro. Ndër të tjera, ajo ka thënë se MKRS-ja ka sjellë një kulturë në botimin e librit shqip dhe një qytetari në shpërndarjen e librit. Duke folur për sfidat dhe peripecitë e vendit në kohën kur

ndalohej depërtimi i librit nëpër kufijtë ku jetonin shqiptarët, kryetarja Keçmezi-Basha ka thënë se ministri Gashi ka arritur rezultate të lakmueshme në misionin e vet të shenjtë që ta kompensojë kohën e humbur. Ndërsa në emër të të gjitha bibliotekave të Kosovës ka folur shefi i personelit në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, Izet Avdyli, i cili u shpreh se dhurimi i këtyre librave në kohën e zhvillimit të hovshëm të internetit është më shumë se një vetëdijësim për librin. "Kjo dhuratë që sot po bën Ministria ka një vlerë dhe simbolikë të veçantë për faktin se shpërndarja e këtyre librave po përfshinë tërë hapësirën shqiptare. Biblioteka Kombëtare, në bashkëpunim me Ministrinë, do të angazhohet që të ofrojë asistencë teknike që librat që po dhurohen sot të shkojnë sa më shpejt në duart e lexuesve", ka deklaruar Avdyli, duke uruar që kjo ngjarje t'i vetëdijësojë edhe institucionet e tjera edukativo-arsimore ta kthejnë vëmendjen te libri dhe ta ndjekin shembullin e mirë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.



## UPZ-ja nënshkruan memorandum bashkëpunimi me Caritas-in zviceran

PRIZREN, 12 KORRIK (ER) - Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren (UPZ) dhe Caritasi Zviceran (CaCH) të premtën kanë nënshkruar memorandum mirëkuptimi për bashkëpunimin dhe zbatimin e aktiviteteve në Fakultetin e Edukimit në kuadër të projektit "Vendosja e standardeve parashkollore të cilësisë së lartë, duke përfunduar arsimin, shkencën dhe ekonominë" (SHPRESE). Marrëveshjen përkatëse e kanë nënshkruar nga UPZ-ja prof. ass. dr. Shemi Morina, prorektor për

mësimdhënie, çështje të studentëve dhe kërkime shkencore dhe prodekani i Fakultetit të Edukimit, prof. ass. dr. Vedat Bajrami, ndërsa në emër të Caritas-it zviceran Kreshnik Basha, zëvendës drejtor për Kosovë. Projekti ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe ofrimit të shërbimeve në arsimin parafillor në Kosovë. Prorektor Morina e vlerësoi lart arritjen e këtij memorandum, duke theksuar se do të shkojë në funksion të rritjes së cilësisë në Fakultetin e Edukimit. Ai ka shtu-

ar se UPZ-ja është i hapur dhe e mirëpret bashkëpunimin me Caritas-in zviceran. Edhe Kreshnik Basha, zëvendës drejtor i Caritas-it zviceran për Kosovë, ka thënë se projekti ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe ofrimit të shërbimeve në arsimin parafillor në Kosovë. Në takim ishin edhe prof. ass. dr. Soner Yildirim, prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Ngritje të Cilësisë dhe drejtori i Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Përparim Avdullahu.





## Slovenia vendos pengesa në vijën kufitare me Kroacinë

LUBJANË, 12 KORRIK - Slovenia do të vendosë pengesa shtesë në kufirin me Kroacinë, me qëllim që t'i ndalojë migrantët e paligjshëm. Ministria e Punëve të Brendshme e Sllovenisë ka konfirmuar se instalimi i pengesave të përkohshme do ta përfshijë vijën kufitare me Kroacinë në gjatësi prej 40 kilometrash.

Vesna Mitriq, zyrtare në Ministrinë e Brendshme të Sllovenisë, i tha gazetës "Veçerni List" se vendosja e barrierës në kufirin me Kroacinë "është në përputhje me një plan të miratuar", por që nuk mund të japë më shumë detaje.

Kufiri midis Kroacisë dhe Sllovenisë është 671 kilometra.

Slovenia filloi të instalonte tela gjemborë gjatë krizës së migracionit në vitin 2015 dhe që atëherë ka vendosur në 50 lokacione. Mediat sllovene raportojnë se në vitin 2017 qeveria shpenzoi 6.6 milionë euro për vendosjen e pengesave.

Vendet e Ballkanit kanë shërbyer si korridor për shumë

migrantë që kanë ikur nga zonat e luftës dhe varfëria.

Agjencia Evropiane e Kufijve, "Frontex", po vazhdon bashkëpunimin me disa vende të Ballkanit përmes kontrolleve të përbashkëta kufitare.

BE-ja vendosi t'i dërgojë njësitet e saj kufitare në këto vende, pas fluksit të migrantëve në të ashtuquaj-



turin "Korridor i Ballkanit". Mijëra migrantë që ikin nga lufta dhe varfëria kanë lëvizur nëpër Ballkan, në përpjekje për të arritur te vendet e pasura në Perëndim.

## Sërish tensione mes ShBA-së dhe Kinës, tash shkaku i Tajvanit



Pekin, 12 korrik - Kina ka njoftuar se do të vendosë sanksione ndaj kompanive amerikane që i shesin armë Tajvanit, pasi Uashingtoni miratoi shitjen e mundshme të tankeve, raketave dhe pajisjeve të tjera në vlerë prej 2.2 miliardë dollarësh.

Ministria e Jashtme e Kinës ka theksuar se shitja e armëve dëmton sovranitetin e Kinës si dhe ndikon në sigurinë kombëtare të saj.

Shtetet e Bashkuara janë furnizuesi kryesor i armëve për Tajvanin e vetëqeverisur, të cilin

Kina e konsideron një krahinë të vetën. Pekini nuk ka hequr dorë kurrë nga mundësia e përdorimit të forcës për ta sjellë ishullin nën kontrollin e tij.

Diplomati kinez Wang Yi ka paralajmëruar ShBA-në se "nuk duhet të luajë me zjarrin" në çështjen e Tajvanit.

Gjatë një vizite në Hungari, Wang ka theksuar se asnjë forcë e huaj nuk mund ta ndalojë ribashkimin e Kinës dhe asnjë forcë e huaj nuk duhet të përpiqet të ndërhyjë.

Zyra e presidentit e Tajvanit ka

shprehur mirënjohje për Qeverinë e ShBA-së për shitjen e armëve. "Tajvani do t'i përshpejtojë investimet në mbrojtje dhe do të vazhdojë t'i thellojë lidhjet e sigurisë me Shtetet e Bashkuara dhe vendet me ide të ngjashme", ka thënë zëdhënësi presidencial Chang Tun-han.

Marrëdhëniet midis Kinës dhe Shteteve të Bashkuara kanë qenë të tensionuara në muajt e fundit për shkak të tregtisë dhe asaj që Uashingtoni e konsideron si militarizim i Kinës në Detin e Kinës Jugore.

## Bideni kritikon paraqitjen e Trumpit në skenën botërore

NJU JORK, 12 KORRIK - Ish-zëvendëspresidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, ka mbajtur fjalimin e parë të madh për politikën e jashtme si kandidat presidencial i Partisë Demokratike. Duke folur në Nju Jork, Bideni ka kritikuar paraqitjen e presidentit amerikan Donald Trump në skenën botërore dhe ka premtuar se do ta luftojë autoritarizmin dhe

paqëndrueshmërinë globale. Bideni, i cili është favorit në mesin e kandidatëve demokratë për zgjedhjet e vitit 2020, ka thënë se qasja "Amerika e para" e Trumpit është "agresive, shkurtpamëse dhe kërcënon interesat e ShBA-së dhe demokracinë në gjithë botën". "Demokracitë në botë presin nga Amerika që t'u përmbahet vlerave që na bashkojnë. Donald

Trump duket se është në ekip tjetër", ka thënë Biden.

Demokratët do ta zgjedhin kandidatin e tyre në korrik të vitit 2020, i cili më pas do ta sfidojë Trumpin në zgjedhjet e nëntorit. Biden foli edhe për synimet e tij në Iran, Afganistan, Jemen e të tjera. Ai ka qenë zëvendëspresident në administratën e ish-presidentit amerikan Barack Obama.



## Sulm vetëvrasës në një dasmë në Afganistan



KABUL, 12 KORRIK - Zyrtarët afganë thanë se së paku gjashtë njerëz u vranë kur një sulmues vetëvrasës hodhi veten në erë në një dasmë në lindje të Afganistanit.

Attaullah Khogyani, zëdhënësi i guvernatorit të provincës Nangarhar, ka thënë se sulmuesi, djalë i ri, i shpërtheu eksplozivët brenda shtëpisë së komandantit të një policie pro-

qeveritare, në qarkun Paçeragam.

Komandanti në shënjestër është Malek Tor, i cili udhëheq një grup që lufton kundër talibanëve dhe grupit ekstremist Shteti Islamik.

Autoritetet thanë se së paku 40 njerëz u plagosën dhe u dërguan në spital.

Përgjegjësinë për sulmin nuk e mori ende asnjë grup.

Provinca Nangarhar është bastion i militantëve të Shtetit Islamik të cilët janë aktivë në kufirin lindor të Afganistanit me Pakistanin.

Grupi ka kryer disa sulme ndaj zyrave qeveritare, shkollave dhe organizatave të ndihmës gjatë viteve të fundit në Nangarhar.

Ushtria amerikane vlerëson se ka rreth 2 000 militantë të Shtetit Islamik në Afganistan.

## Dërgesat e para të sistemit raketor rus arrijnë në Turqi

ANKARA, 12 KORRIK - Ministria e Mbrojtjes e Turqisë ka njoftuar se pjesët e para të sistemeve ruse të mbrojtjes raketore S-400 arritën të premtën në Ankara dhe se do të vazhdojnë të arrijnë edhe në ditët në vijim.

Ministria e Mbrojtjes e Turqisë ka theksuar se ngarkesa me S-400 u dërgua në bazën ajrore Murted.

"Kur sistemi të kompletohet ai do të nisë të përdoret në mënyrën që e përcaktojnë autoritetet përkatëse", është thënë në deklaratën e Ministrisë së Mbrojtjes së Turqisë.

Shërbimi Federal i Rusisë për Ushtri dhe Bashkëpunim teknik e konfirmoi fillimin e dërgesave. Por, kjo marrëveshje e Turqisë

me Rusinë i ka dëmtuar marrëdhëniet e saj me Shtetet e Bashkuara.

ShBA-ja thotë se raketat S-400 janë kërcënim për avionët e saj luftarakë F-35.

ShBA-ja i ka kërkuar Turqisë t'i anulojë blerjet, në të kundërtën ka paralajmëruar se Turqia mund të përballet me sanksione.





E jashtëzakonshme

## E çuan për ta bërë syret, vogëlushi hipën në kulm të spitalit nga frika

Një djalë pesëvjeçar në Indonezi ka hipur në kulmim e një klinike mjekësore dhe ka refuzuar të zbriste, pasi prindërit e çuan për ta bërë syret. Vogëlushi iku nga klinika dhe u ngjit në çatinë e ndërtesës ku ishte duke qëndruar, duke refuzuar që të zbriste për dy orë. Mjekja dr. Anik Sutari ka thënë se kurrë nuk kishte parë diçka të tillë prej se punon në qytetin e Serangut, kryeqytetin e provincës



Banten, në ishullin indonezian të Javas. Mjekja në llogarinë e saj në "Facebook" ka publikuar fotografimin e vogëlushit teksa qëndronte mbi kulmin e spitalit.

FOTO E DITES



Një zog mbulon një tjetër gjatë fluturimit derisa në sqep mban një peshk të marrë në lumin në Portland. /AP/

E rrallë

## Adoleshentja shkon në mbrëmjen e maturës me veturën e mbuluar me kristale "Swarovski"

Një adoleshente vodhi shfaqjen e mbrëmjes së maturës së shkollës së saj teksa mbërriti në festë me një "Rolls Royce Phantom" të shkëlqyeshëm, mbuluar me më shumë se katër milionë kristale "Swarovski". Ishtea Sanah Akhtar, 16 vjeçe, nga



Blackburni që bëri një hyrje spektakolare, me makinën që kushtonte 500 paund për t'u marrë me qira jo më shumë se 15 minuta. Ajo, gjithashtu, për të rënë në sy kishte veshur një fustan mahnitës me ngjyrë blu dhe gri, që kushtonte 260 paund.

## BARSOLETA E DITËS



Burrë dhe grua flasin për pushimet por, para se të vendosin, e shohin nëse kanë buxhet. Pasi e analizojnë buxhetin, burri thotë:  
- Valla unë nuk kam nevojë për pushime, se nuk jam aspak i lodhur.  
Gruaja:  
- Valla as unë, se po ndihem shumë në formë.



## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)  
**"THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D**

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min  
**Rolet:** Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan  
**Regjia:** Chris Renaud and Jonathan Del Val



Ne ora 18:00  
**"X-Men; Dark Phoenix"**

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

**Rolet:** James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain  
**Regjia:** Simon Kinberg



Në ora 20:00

**"MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,**  
Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

**Rolet:** Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson  
**Regjia:** F. Gary Gray



Ne ora 22:00

**"M A"**

Horror/Triller; 1 ore 39 min

**Rolet:** Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown  
**Regjia:** Tate Taylor



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Hëna në shenjë ju favorizon në çdo aspekt të jetës, por më shumë në atë sentimental. Jeni gjithë kohës në krahët e partnerit.</p>	 <p><b>DEMI</b> Sot jeni ju protagonistët e ditës në sajë të një marrëveshjeje mjaft të favorshme që keni arritur ta mbyllni.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Do t'ju duhet të jepni prova që mund të përballoni një situatë stresi pa u alarmuar dhe pa ju zënë paniku.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Çdo gjë që ka lidhje me ju sot do të jetë e ekzagjeruar. Do të doni shumë, do të luftoni shumë, do të mërzhiteni shumë dhe në çdo rast nuk do të ndaloni.</p>	 <p><b>LUANI</b> Sot do të jeni kapricioze për çdo gjë në familje dhe në punë. Nuk do t'ju pëlqejë asgjë që do t'ju propozohet.</p>	 <p><b>VIRGJËRESHA</b> Edhe pse keni dyshime në një bisedë të bërë kohët e fundit, nuk do t'i shprehni ato pa u siguruar nëse qëndrojnë apo jo.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Është periudha më e mirë për të folur për pushime dhe për udhëtime. Doni të vizitoni kultura të ndryshme dhe të panjohura.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Xhelozit dhe debate në çdo moment me partnerin, tregojnë se duhet të vendosni një kufi ose duhet të lini gjithçka.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Një ditë shumë e mirë sot për të gjithë ju që keni punuar fort për t'i arritur qëllimet tuaja. Më në fund, pak dritë në fund të tunelit.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Disi në mënyrë të ndrojtur, por me shumë dashuri do të arrini t'i shprehni ndjenjat e njeriut të zemrës. Kjo gjë do t'ju afrojë më shumë bashkë.</p>	 <p><b>UJORI</b> Një ditë shumë e zakonshme dhe pa asnjë kulm të rëndësishëm. Gjithsesi ju dini të argëtoheni në çdo çast.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Sot do të shkojë gjithçka siç e keni parashikuar, mëje dhe më mirë. Jeni nën një aureolë optimizmi që do të bëjë që gjithçka të shkojë vaj.</p>



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com

**Sport**

**QENDRA SPORTIVE**

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

# Dy medalje dhe një dështim në Hungari

Ekipi i xhudos i ka siguruar Kosovës dy medalje të argjendta me Nora Gjakovën dhe Distria Krasniqin, kurse dështim tejet befases ishte mbetja pa medalje e Majlinda Kelmendit. Dy medalje të tjera Kosova mund t'i presë nga Loriana Kuka dhe Akil Gjakova

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 12 KORRIK - Pas medaljeve të fituara në Lojërat Evropiane "Minsk 2019", ekipi i xhudos së Kosovës arriti të fitojë edhe dy medalje të tjera të argjendta në Grand Prixin e Budapestit të Hungarisë. Të premtën garuan tri xhudiste të Kosovës, ku me medalje të argjendta u stolisën Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi, kurse Majlinda Kelmendi befanoi me faktin se mbeti pa medalje pas një kohe të gjatë. Medalistja e argjendtë në "Minsk 2019", Nora Gjakova, nuk arriti ta kalojë në finale brazilianen Rafaela Silva në kategorinë 57 kilogramë dhe në këtë mënyrë është dashur të pajtohet me medaljen e argjendtë. Nora rrethin e parë e kaloi pa luftë, kurse më pas, në rrethin e dytë, e mposhti rusen Diana Dzhigaros. Në xhiron e tretë, Nora triumfoi ndaj garueses nga Bregu i Fildishtë, Zouleiha Abzetta Dabonne dhe në këtë mënyrë është kualifikuar në gjysmëfinale. Ndërsa për t'u kualifikuar në finale, Nora e mposhti xhudisten e Panamasë, Miryam Roper. Mirëpo në finale është mposhtur nga garuesja braziliane Rafaela Silva. Përveç medaljes, Nora fitoi 490 pikë olimpikë për "Tokio 2020".

Xhudistja tjetër Distria Krasniqi ka shkëlqyer në Grand Prixin e Hungarisë, por i ka munguar fati që të stoliset me medaljen e artë. Distria në këtë garë e fitoi medaljen e argjendtë, pasi në finale është mposhtur nga garuesja japoneze Funa Tonaki në kategorinë -48 kilogramë. Krasniqi rrethin e parë e kaloi pa luftë, kurse në rrethin e dytë arriti ta eliminojë rusen Sabina Giliazova. Në rrethin e tretë Krasniqi e mposhti kinezin Yanan Li dhe u kualifikua në gjysmëfinale. Në këtë fazë xhudistja pejane e mposhti spanjollën Julia Figueroa, kurse në finale është dashur të pajtohet me humbje, sepse Funa Tonaki doli me e suksesshme. Përveç medaljes së argjendtë, Distria ka fituar edhe 490 pikë të reja olimpikë. Befasia më e madhe të premtën në



Hungari ishte dështimi i Majlinda Kelmendit për të fituar medalje. Sportistja më e suksesshme shqiptare pas një kohe të gjatë mbetet pa medalje të fituar. Kelmendi rrethin e parë e kaloi pa luftë, ndërsa në rrethin e dytë e mposhti mexikanen Luz Olvera. Në rrethin e tretë Majlinda fitoi edhe ndaj gjeorgjanes Tetiana Levytka-Shukvani.

Në gjysmëfinale Kampionia Olimpikë është mposhtur nga japonezja Chishima Maeda. Majlinda në garë për medaljen e bronzit është mposhtur nga spanjollja Ana Perez Box. Kelmendi është dashur të pajtohet me vendin e pestë, por ajo fitoi 252 pikë olimpikë. Në ditët e ardhshme pritet që të garojnë edhe Loriana Kuka dhe Akil Gjakova.

SHKURT

## Pajaziti konfirmon marrëveshjen me Vëllaznimin

Skuadra e Vëllaznimit ka arritur marrëveshje me trajnerin Sadat Pajaziti. Lajmin për arritjen e marrëveshjes me skuadrën kuqezi e ka arritur vetë trajneri nga Kosova Lindore për "Olle". "Mund të konfirmoj që kemi rënë dakord në parim dhe brenda 2-3 ditësh mund të finalizohet gjithçka", ka thënë Pajaziti, i cili i ka drejtuar Dritën, KEK-un, Gjilanin dhe Drenicën.

## Goztepe kërkon Alitin

Superligës turke mund t'i shtohet edhe një futbollist nga Kosova. Fjala është për mbrojtësin Fidan Aliti i cili po kërkohet nga Goztepe. Lajmi është bërë me dije nga e përditshmja turke "Sabah". Fidan Aliti ka shkëlqyer me fanellën e Kalmarit dhe në këtë afat kalimtar mund të largohet nga Suedia për të provuar një aventurë të re. 25-vjeçari ka luajtur edhe Old Boys, FC Luzern, FK Sheriff Tiraspol, Slaven Kopriwnica dhe Skënderbeun.

## Vushtrria transferon Gashin, rikthen Shalën

Skuadra e Vushtrrisë që e fitoi statusin e anëtares së Superligës është përforcuar me sulmuesin nga Rahoveci, Qëndrim Gashi. 24-vjeçari ishte pjesë e KF Lirisë së Prizrenit dhe pjesë e grupmohave të Përfaqësueses së Kosovës që nga U17, U19 dhe U21, kurse me skuadrën e Vushtrrisë ka nënshkruar kontratë njëvjeçare. Skuadra e Vushtrrisë e ka rikthyer edhe mesfushorin Bashkim Shala. "Gladiator" i sezonit 2013/14, rikthehet edhe një herë për t'i dhënë Vushtrrisë atë që e dinë më së miri, t'i luftojë për ngjyrat bardhekaltër", thuhet në njoftimin e skuadrës së Vushtrrisë.

## Dy humbje të Kosovës në basketboll

PRISHTINË, 12 KORRIK - Kosova U-20 në konkurrencën e meshkujve ka zhvilluar ndeshjen e parë në Kampionatin Evropian, Divizioni B, që po zhvillohet në Portugali. Djelmohat e rinj kanë pësuar

86:37 nga Estonia, në një ndeshje ku ishin edhe të hendikepuar, sepse Dardan Kapiti dhe Ardit Pepaj, dy shtyllat e Kosovës, nuk ishin 100 % të gatshëm për shkak të lëndimeve dhe kanë luajtur

me minuta të kufizuar. Sidoqoftë, përzgjedhësi Ibrahim Karabegu u ka dhënë hapësirë të gjithë lojtarëve përballë Estonisë, që ka lojtarë në toplotat evropiane. Leon Neziri realizoi 12 pikë, kurse

Meriton Ismaili nëntë. Synimi i Kosovës në këtë Evropian është të fitojë më shumë përvojë në gara të tilla. "Dardanët" ndeshjen e ardhshme e zhvillojnë të shtunën ndaj Holandës nga ora 17:00.

Ndërkohë, Kosova U-18, në konkurrencën e femrave, ka pësuar 61:83 nga Bullgaria në luftë për pozitën 17-22. Dea Pushkollit me 17 pikë dhe Arba Hashani me 15 u dalluan më shumë te Kosova.



## Griezmanni zyrtarisht lojtar i Barcelonës

**BARCELONË, 12 KORRIK** - Antoine Griezmann edhe zyrtarisht është lojtar i Barcelonës. Skuadra nga "Camp Nou" e ka paguar klauzolën e blerjes prej 120 milionë eurosh për lirimin e Griezmannit nga Atletico Madrid.

Sulmuesi do të nënshkruajë kontratë me Barcelonën deri më 30 qershor 2024, kurse klauzola do të jetë 800 milionë euro. Antoine Griezmann ka shkëlqyer në La Liga me fanellën e Real Sociedadit, kurse më pas edhe me

fanellën e Atletico Madridit, derisa ka qenë një nga më meritoret për triumfin e Francës në Kupën e Botës. Ende nuk janë dhënë detaje se kur futbollisti francez do të prezantohet si lojtar i Barcelonës.



## Mulaomeroviqi publikon listën e gjerë të Kosovës



**PRISHTINË, 12 KORRIK** - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll të hënën (15 korrik) nga ora 10:00 do ta ketë grumbullimin e parë në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë në kuadër të fazës së tretë të parakualifikimeve për "Eurobasket 2021". Përzgjedhësi i Kosovës, Damir Mulaomeroviqi, ka shpallur listën e gjerë me 16 basketbollistë. Kosova më 20 dhe 21 korrik do t'i zhvillojë edhe dy ndeshje

miqësore me Sllovakinë në udhëtim. Kosova në parakualifikime është në grup me Luksemburgun dhe Britaninë e Madhe (ndeshje vajtje-ardhje), ku fituesi i grupit kualifikohet tutje. Raundi i tretë i parakualifikimeve për "Eurobasket 2021" do të zhvillohet prej 3 deri më 21 gusht. Dardanët ndeshjet si vendës do t'i zhvillojnë në palestrën "Minatori" në Mitrovicë.

### LISTA E BASKETBOLLISTËVE

Divine Miracle Myles, Valon Bunjaku, Dardan Berisha, Mikailë Tmusiq, Arian Qallaku, Edmond Azemi, Drilon Hajrizi, Erjon Kastrati, Gëzim Morina, Fisnik Rugova, Lis Shoshi, Meriton Ismaili, Atik Koshi, Dardan Kapiti, Ujkan Karanezi, Samir Zekiqi.

## Marku gati për duelin e katërt si profesionist

**LONDËR, 12 KORRIK** - Florian Marku po bëhet gati për duelin e katërt si profesionist, vetëm pak muaj pasi debutoi në këtë sport. Boksieri shqiptar i ka fituar me nokaut të tri duelet e mëparshme dhe në përballjen e radhës vjen një kundërshtar i një niveli më të lartë. Ditën e shtunë 26-vjeçari do të jetë pjesë e evenimentit të organizuar nga promotori më i njohur anglez Frank Warren, në "O2 Arena", Londër.

Menaxheri i Markut, Steve Goodwin, ka folur për kundërshtarin e radhës të Markut dhe ka ndarë një premtim që atleti shqiptar i ka bërë për këtë duel.



"Florian Marku do t'a zhvillojë duelin e katërt të karrierës së tij si profesionist. Do të ndeshet me Tommy Broadbent, një boksier që ka një rekord pozitiv me 8 fitore e 4 humbje. Është një kundërshtar më i vështirë nga tre duelet e mëparshme.

një test i vërtetë për Florian Markun. Tani ai kërkon të vihet kundër kundërshtarëve të mirë. Dëshiron të tregojë se është një boksier cilësor. Më ka thënë se nëse nuk ia del t'i fitojë ndeshjet e radhës, do ta lërë fare boks", ka deklaruar ai.

### SHKURT

#### CAS godet Skënderbeun, dënimi mbetet i pandryshuar

CAS i ka dhënë një goditje fatale skuadrës së Skënderbeut pasi e ka lënë në fuqi dënimin për përjashtimin nga kompeticionet evropiane. Skënderbeu është fajtor për fiksion rezultatesh teksa është dënuar nga UEFA edhe me një gjobë prej një milion eurosh. Megjithatë besimi në kampin korçar ishte i madh se nga Lozana mund të vinte një lajm i mirë, kjo gjë nuk ka ndodhur, teksa ëndrra e tifozëve bardhekuq është vrarë përfundimisht. "Gjykata e Arbitrazhit e Sportit ka hedhur poshtë apelimin nga klubi i futbollit shqiptar Skënderbeu kundër vendimit të dhënë nga Komisioni i Apelit të UEFA-s më 26 prill 2018, i cili konfirmoi vendimin e dhënë më 29 mars nga komisioni i UEFA-s për Etikën dhe Disiplinën, i cili e shpalli Skënderbeun përgjegjës për aktivitete të ndryshme manipulimi ndeshjesh dhe e përjashtoi klubin nga kompeticionet e UEFA-s për të cilat do të kualifikohej në 10 vjetët e ardhshëm dhe urdhëroi klubin të paguante një gjobë prej një milion eurosh. Në maj 2018 Skënderbeu apeloj në CAS duke kërkuar që vendimi dhe sanksioni disiplinor të anuloheshin. Arbitrazhi i CAS u zhvillua nga një panel juristësh të KAS të cilët zhvilluan një mbledhje me palët në zyrat e CAS më 16 prill 2019. Në bazë të evidencave, paneli i KAS arriti në përfundimin e kënaqshëm, se Skënderbeu ishte përgjegjës për aktivitetet manipulime ndeshjesh dhe arriti në konkluzionin se sanksionet disiplinore të dhëna nga komisioni disiplinor i UEFA-s ishin në përmasë të drejtë dhe të justifikuar. Në përputhje me këtë, ai hodhi poshtë apelimin dhe konfirmoi vendimin", thuhet në vendimin e KAS-it.

#### Hysaj pranon ofertën e Atletico

Mbrojtësi shkodran i kombëtares shqiptare të futbollit, Elseid Hysaj, ka pranuar parimisht kalimin tek Atletico e Madridit si skuadra më serioze në ofertën e saj për ta blerë kartonin e lojtarit kuqezi. Hysaj nuk konsiderohet prej muajsh një alternativë e parë për formacionin e Napolit dhe skuadra jugore i ka bërë të ditur zyrtarisht agjenti për të gjetur një destinacion tjetër, por pak janë skuadrat e gatshme të shpenzojnë shumë. Atletico Madrid është ajo që ka insistuar për firmën me futbollistin shqiptar dhe është ajo që ka ngritur më shumë ofertën në drejtim të skuadrës së Serisë A. 25 milionë euro do të paguajë Atletico e Madridit për Hysajn, një mbrojtës që u kërkuar dhe nga Chelsea, por asnjëherë në tratativa zyrtare.

#### Pensionohet Crouchi

Ish-sulmuesi i Kombëtares së Anglisë, Peter Crouch, ka vendosur të pensionohet pas një karriere mjaft të pasur në nivel klubesh, por edhe në Kombëtare. "I kam pasur 23 vjet për t'u përgatitur për këtë moment, por tani është momenti. Ti e kupton se asgjë nuk mund të të përgatisë për këtë gjë. Koha ka ardhur që unë t'i referohem vetes si ish-futbollist, t'i jap fund këtij rrugëtimi të mrekullueshëm që e nisa si 16-vjeçar", ka thënë Crouch. 38-vjeçari ka luajtur për Tottenham Hotspur, Southampton, Liverpool, Stoke City dhe disa klube të tjera.

#### Ruiz, Joshuas: Tani vendos unë, ja ku do ta zhvillojmë revanshin

Boksieri britanik Anthony Joshua dhe menaxheri i tij Eddie Hearn do t'i përgatisin sërish valixhet për të shkuar në Amerikë ose Meksikë. Kampioni i botës në peshën e rëndë, meksikani Andy Ruiz Jr, ka konfirmuar se nuk ka asnjë shans që revanshi mes tij dhe Joshuas të zhvillohet në Britaninë e Madhe. Ai preferon Meksikën ose Amerikën. "Dua që revanshi të zhvillohet në vendlindjen time, në Meksikë. Ose eja të dublojmë sërish në Nju Jork, si herën e parë ose në Las Vegas", tha Ruiz për TMZ. "Nuk më intereson fare nëse Joshua e pëlqen apo jo këtë deklaratë. Tashmë jam unë ai që vendos dhe do të bëhet si them unë", u shpreh Andy Ruiz Jr.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
